

# **PENGESAT NË TREGTINË E JASHTME: ROLI I BARRIERAVE JOTARIFORE<sup>1</sup>**

**DRAFT**

**A. Maçellari<sup>2</sup>  
S. Belortaja<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Studimi është ndërmarrë nga ACIT (Qendra Shqiptare për Tregti Ndërkombëtare), project i ISB, i financuar nga USAID.

<sup>2</sup> Prof. Dr. Ahmet Maçellari është pedagog në Fakultetin e Ekonomisë, UT, dhe ekspert i jashtëm pranë ACIT (Albanian Center for International Trade).

<sup>3</sup> Dr. Selim Belortaja është drejtor ekzekutiv i ACIT.

# PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE	3
I. PENGESAT JOTARIFORE, KLASIFIKIMI DHE MATJA E EFEKTIT	5
1.1 Klasifikimi i pengesave jotarifore	
2.2 Matja e efekteve të pengesave jotarifore	
II. PENGESAT JOTARIFORE DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE	15
2.1 Liberalizimi tarifar dhe qëndrimi ndaj kufizimeve sasiore	
2.2 Lehtësimi i procedurave të zhdoganimit	
2.3 Rregullimi i subvencioneve dhe masave kundërvepruese	
2.4 Rregullimet teknike dhe standardet	
2.5 Masat sanitare dhe fitosanitare	
2.6 Masat që ndikojnë në investimet që lidhen me tregtinë	
2.7 NTB dhe zhvillime sektoriale	
2.8 Raundi i Dohas dhe pengesat jotarifore	
2.9 Pengesat jotarifore, OBT dhe Shqipëria	
III. BARRIERAT JOTARIFORE, BASHKIMI EVROPIAN DHE SHQIPËRIA	33
3.1 Bashkimi Evropian dhe pengesat jotarifore	
3.2 Procesi i integritimit evropian dhe pengesat jotarifore në Shqipëri	
PËRFUNDIME	48
REFERENCA	49
ANEX	52

## HYRJE

Procesi i liberalizimit tregtar dhe globalizimit, i intensifikuar veçanërisht gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, mbështetet në terrenin e fortë të *përfitimeve* që ai sjell jo vetëm në përmasat e ekonomisë globale - nëpërmjet një përndarjeje më eficiente të burimeve prodhuese dhe uljes së kostove të transaksionit, por edhe për çdo ekonomi të veçantë - nëpërmjet rritjes në mirëqënien kombëtare, alokimit më eficient të burimeve ekonomike brenda vendit, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë në tregjet ndërkombëtare, dhe uljes së kostove që shoqërojnë politikat aktive tregtare<sup>4</sup>.

Megjithatë, procesi i hapjes tregtare dhe i liberalizimit të politikave tregtare, megjithë progresin substancial të realizuar, nuk mund të jetë një proces i qetë, drejtvijëzor, që thjesht shpërndan përfitime për të gjithë, dhe të gjithë, vende apo grupe interesash brenda vendeve, mbeten njësoj të kënaqur. Procesi shoqërohet edhe me *kosto* që shpesh rëndojnë në mënyrë disproporcionale në grupe interesash të caktuara, dhe jo rrallë kostot për një grup interesi apo një vend, përkthehen si përfitime për një grup tjetër interesi brenda vendit, apo për një vend tjetër, pavarësisht se në zhvillime afatgjata tregtia e lirë sjell përfitime për të gjitha palët e përfshira në të.

Fakti i thjeshtë i shoqërimit të procesit të liberalizimit tarifor me rritjen e shumëllojshmërisë dhe nivelit të pengesave tregtare jotarifore, është dëshmi e kompleksitetit të vetë procesit të liberalizimit tregtar dhe njëkohësisht dëshmi e kompleksitetit të interesave që përcaktojnë ecurinë e këtij procesi.

Pengesat tregtare jotarifore po tërheqin gjithnjë e më shumë vëmendjen jo vetëm të kërkuesve të fushës përkatëse; ato po dalin gjithnjë e më shumë në krye të axhendës së veprimtarisë së OBT, dhe të institucioneve të tjera ekonomike ndërkombëtare. Orientimi i vëmendjes drejt pengesave jotarifore lidhet me efektin e tyre përgjithësisht shumë më të ashpër se ai i tarifave. Por liberalizimi tregtar jotarifor, ndryshe nga disipinimi i politikave tregtare të bazuara në përdorimin e instrumenteve tariforë, duket një proces më i vështirë (megjithëse edhe procesi i liberalizimit tarifor vazhdon të përballlet me mjaft probleme, si piku tarifor, shkallëzimi tarifor, etj.). Vështirësitë lidhen me *identifikimin* e këtyre pengesave dhe janë në përpjesëtim të drejtë me rritjen e shumëllojshmërisë dhe karakterin jotransparent të tyre. Vështirësitë lidhen edhe me *matjen e efektit* të këtyre pengesave, kur është fjala për pengesa jotarifore josasiore. Kjo është e vërtetë veçanërisht për masa që motivohen nga synimi i ruajtjes së interesave të konsumatorëve, apo i shëndetit të njerëzve, të kafshëve apo të bimëve; nga synimi i sigurisë kombëtare, etj.

Në rastin e Shqipërisë, sikurse në rastin e çdo vendi që është duke ndërtuar institucionet e tregut, problemi fiton një dimension të ri. Një sërë pengesash jotarifore, sikurse janë rregullat teknike dhe standardet, rregullat të testimi dhe çertifikimit, rregullat sanitare e fitosanitare, etj., përpara se të konsiderohen si *pengesa*, ato përfaqësojnë *masa* që duhen marrë dhe *institucione* që duhen ngritur pikërisht për ta bërë tregun funksionues.

---

<sup>4</sup> Sipas Hertel and others (World Bank (2002), pas 2005 (kohë kur përfundojnë afatet për zbatimin e përshkallëzuar të angazhimeve të përcaktuara në Raundin e Uruguajt), nga një reduktim i mëtejshëm me 40% në tarifatat dhe subvencionet e eksporteve të produkteve bujqësore, do të përfitohej një rritje e të ardhurave reale globale në masën 60 miliardë dollarë amerikanë në vit. Në qoftë se këtyre masave liberalizuese i shtohet edhe një reduktim prej 40% i subvencioneve të prodhimit të brendshëm bujqësor, rritja e të ardhurave reale globale do të arrinte në 70 miliardë dollarë amerikanë në vit (World Bank (2002), Sam Laird, Market Access Issues and the WTO: an Overview).

Një dimension tjetër shtohet, po të mbajmë parasysh proceset integruese në të cilat është përfshirë Shqipëria. Veçanërisht procesi i integritit evropian të vendit nënkupton, përveç liberalizimit tregtar, edhe ndërtimin e institucioneve funksionuese të pajtueshme me parimet dhe kërkesat e 'tregut të brendshëm ('internal market'). Në këtë kuptim, masat jotarifore përpara se të bëhen pengesa, janë 'institucione tregu' dhe 'institucione integrimi'.

Së fundi, situata e bilancit tregtar në Shqipëri imponon një vëmendje të veçantë lidhur me politikat nxitëse ndaj prodhimit dhe ndaj eksportit. Nxitja e eksportit kërkon rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë, të firmave dhe produkteve shqiptare. Por, kjo nuk mund të bëhet pa mbajtur parasysh dhe pa iu përshtatur rregullave teknike dhe standardeve që zbatohen në tregjet e eksportit, që aktualisht por edhe në të ardhmen do të vazhdojnë të jenë kryesisht tregje evropiane. Masat jotarifore përkatëse fitojnë kështu një dimension të ri, atë të *rritjes së aftësisë konkurruese* të ekonomisë. Edhe pse në punim do të vazhdojmë ta përdorim termin 'pengesa jotarifore', në shumë raste do të duhej të mbaheshin parasysh dimensionet 'pozitive', pra dhe kuptimi i gjerë i tyre si 'masa jotarifore'.

Punimi përmban tre pjesë. Në pjesën e parë do të trajtohet përmbajtja dhe struktura e pengesave tregtare jotarifore. Pjesa e dytë do t'i kushtohet 'administrimit' të problematikës së pengesave jo tarifore nga ana e GATT/OBT-së. Në pjesën e tretë do të përqëndrohemi në analizën e pengesave joatrifore nga pikëpamja e procesit të integritit evropian të Shqipërisë. Punimi do të mbyllet me disa përfundime dhe sugjerime politike.

# I. PENGESAT JOTARIFORE, KLASIFIKIMI DHE MATJA E EFEKTIT

## 1.1 Klasifikimi i pengesave jotarifore

Koncepti i pengesave jotarifore (NTB) është mjaft kompleks. Kompleksiteti fillon që me emërtimin e konceptit. Agjencitë e Gjenevës<sup>5</sup> preferojnë të përdorin emërtimin ‘masa jotarifore’ për të evituar probleme konceptuale dhe matjeje të efekteve që mund të lidhen me emërtimet ‘pengesa jotarifore’, apo ‘deformime jotarifore’, që hasen shpesh në literaturën ekonomike. Një nga problemet konceptuale lidhet me dallimet midis efekteve reale dhe atyre potenciale të një ‘pengese jotarifore’. Është shumë e mundur që një ‘pengesë jotarifore, edhe kur është konceptuar si instrument pengues ndaj tregtisë, të mos ushtrojë asnjë efekt *kufizues* mbi të. Për shembull, në qoftë se çmimet botërore të një produkti ngrihen mbi çmimin kombëtar të mbështetur<sup>6</sup> nga një ‘mbitarifë e ndryshueshme’ (variable levy), në këtë rast ky instrument nuk do të vepronte, megjithëse si mekanizëm ai vazhdon të mbetet në fuqi. Po kështu, një kuotë do të vazhdojë të mbetet në fuqi si ‘masë’ jotarifore edhe në rastin kur ajo mund të jetë më e lartë se kërkesa kombëtare, duke mos ushtuar asnjë efekt kufizues mbi importin. Qoftë edhe për të mbajtur parasysh dallimin midis efektit real dhe atij potencial, emërtimi ‘masë jotarifore’ konsiderohet si më i përshtatshëm se emërtimi ‘pengesa jotarifore’. Sipas Bora, Kuwahara and Laird (2002), koncepti ‘masa jotarifore’ nënkupton të gjitha instrumentet e politikës tregtare përveç tarifave, megjithëse efektet e tyre kufizuese (në qoftë se kanë të tilla) mund të ndryshojnë nga një vend në tjetrin, apo nga një periudhë kohore në tjetrën.

Emërtimi ‘masa jotarifore’ do të ishte i përshtatshëm veçanërisht për një vend në tranzicion si Shqipëria, që është duke ndërtuar institucionet e tregut, ndër të tjera edhe institucionet që lidhen me rregullat teknike, standardet, testimin dhe çertifikimin, rregullat sanitare dhe fitosanitare, rregullat për prokurimin publik, etj. Të gjitha këto, në kushte të caktuara, mund të veprojnë edhe si pengesa jotarifore ndaj tregtisë. Por para se të jenë pengesa, ato janë masa dhe institucione të nevojshme për ruajtjen e shëndetit të njerëzve, bimëve, kafshëve, për ruajtjen e mjedisit, për sigurinë kombëtare, për ruajtjen dhe inkurajimin e konkurrencës në treg, etj.<sup>7</sup>

Kompleksiteti konceptual i ‘pengesave jotarifore’ lidhet jo vetëm me emërtimin, por, dhe sidomos, me përmbajtjen e tyre. Termi pengesa jotarifore është një koncept shumë i gjërë dhe që ka ardhur duke u zgjeruar, përderisa me kalimin e kohës, me thellimin e liberalizimit tarifor dhe përshpejtimin e proceseve të integritit rajonal, janë prezantuar masa të reja jotarifore.

Në literaturë ndeshen përkufizime të ndryshme të pengesave jotarifore. Përgjithësisht, pengesat jotarifore përgjithësisht përcaktohet si çdo rregullim i tregtisë i ndryshëm nga tarifa, ose çdo politikë tjetër që kufizon tregtinë ndërkombëtare. Sipas Bora, Kuwahara dhe Laird (2002, f. 2), “termi ‘masa jotarifore-NTM’ përfshin jo vetëm

<sup>5</sup> WTO (OBT), UNCTAD, dhe WCO (Organizata Botërore e Doganave).

<sup>6</sup> Çmimi i mbështetur është një çmim minimal “kufi”, që nuk duhet të kalohet nga çmimet i importit i një malli të caktuar. Në qoftë se çmimi i importit është më i ulët se çmimi kufi, ndaj tij vepron ‘mbitarifa e ndryshueshme’ që e barazon atë me çmimin kufi. Mbitarifa e ndryshueshme është përdorur si instrument për mbrojtjen e prodhimit bujqësor në kudadrin e Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) të BE.

<sup>7</sup> Megjithëse më poshtë do të vazhdojmë të përdorim termin ‘pengesa jotarifore’, shpesh është e rëndësishme të mbajmë parasysh kuptimin e gjërë të tyre, si ‘masa jotarifore’.

kufizimet e importit, por edhe kufizimet e eksportit, subvencionimet e eksportit dhe të prodhimit, dhe çdo masë tjetër me efekt të ngjashëm”.

Autorët Bora, Kuwahara dhe Laird (2002), megjithatë, shprehen se ‘ndoshta përkufizimi më i kënaqshëm teorik është ai i dhënë nga Baldwin (1970), që i përcakton ‘deformimet jotarifore’ si “çdo masë (publike apo private) që shkakton që mallrat dhe shërbimet e tregtuara midis vendeve, ose burimet e destinuara për prodhimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve, të alokohen në mënyrë të tillë që redukton të ardhurat reale potenciale botërore”. Esenciale në këtë përkufizim është se efekti deformues i masave jotarifore shprehet, në fund të fundit, në alokimin joefiçent të mallrave dhe shërbimeve si dhe të burimeve të tyre. Megjithatë, përfshirja në këtë përkufizim e konceptit të të ardhurave reale botërore e bën të vështirë, në mos të pamundur, llogaritjen e efektit të këtyre masave. Prandaj, për të bërë të mundur llogaritjen e efektit, nevojiten përkufizime më praktike, më operacionale të pengesave jotarifore, dhe këtij qëllimi i shërbejnë grupimet e këtyre pengesave. Në Aneks (Tabela A1) është paraqitur klasifikimi i koduar i përdorur nga UNCTAD<sup>8</sup> i më se 100 pengesave tarifore dhe jotarifore, në të cilin megjithatë mungojnë masa jotarifore që lidhen me prodhimin dhe eksportin.

Laird dhe Vossenaar (1991), bazuar në efektin e synuar apo faktik të masave jotarifore, i klasifikojnë ato në pesë grupe, (i) masa për kontrollin e vëllimit të importit; (ii) masa për kontrollin e çmimeve të importit; (iii) masa monitoruese dhe investiguese; (iv) masa që lidhen me prodhimin dhe eksportin, dhe (v) barrierat teknike ndaj tregtisë. Në tabelën 1, përveç këtyre grupeve, është përfshirë edhe grupi i procedurave tarifore dhe praktikave administrative, bazuar në klasifikimin e Tschäni and Wiedmer (2001).

Gjithashtu, duke mbajtur parasysh edhe klasifikimin e këtyre të fundit, është zgjeruar përmbajtja e çdo grupi, duke përfshirë edhe elementë shtesë të specifikuar.

*Masat për kontrollin e vëllimit të importeve* synojnë drejtpërdrejt në kufizimin e importeve nëpërmjet ndalimit të importeve, kuotave dhe licensave, importimit shtetëror apo të monopolizuar, kufizimit vullnetar të eksporteve, apo masave të tjera të ngjashme. Tschäni and Wiedmer (2001) në këtë grup përfshijnë edhe kontrollet valutore dhe kontrolle të tjera financiare, marrëveshje bilaterale diskriminuese, kërkesat për përdorimin e inputeve vendase, dhe tregtinë mall me mall apo me para në dorë (counter trade).

*Masat për kontrollin e çmimeve të importit*, si tarifatat e ndryshueshme, tarifatat stinore, kuotat tarifore, masat antidumping dhe ato kundërvepruese, çmimet e referencës dhe ato dysheme, kufizimet vullnetare të çmimeve të importit, etj., synojnë në rritjen e çmimit të importit, dhe në këtë mënyrë, në kufizimin e vëllimit të tij.

*Masat monitoruese të çmimit dhe vëllimit të importeve*, që përfshijnë licensimin automatik, mbikëqyrjen e importeve, mbikëqyrjen dhe investigimin e çmimeve, investigimin antidumping apo atë kundërveprues, kanë efekte bezdisëse dhe frenuese mbi importin, përderisa mund të shërbejnë si parathënie për masa të tjera më të drejtpërdrejta.

*Masat që lidhen me prodhimin dhe eksportin*, si subvencionet ndaj prodhimit dhe eksportit; ndalimet dhe taksat ndaj eksportit, etj. ndikojnë në kufizimin e importit (nëpërmjet subvencionimit të prodhimit vendas), në mbështetjen e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të eksporteve, apo edhe në ndalimin ose kufizimin e këtyre të fundit. Subvencionet ndaj prodhimit janë më të zakonshme në sektorin bujqësor, por kanë qenë përdorur edhe si instrumente të politikave industriale të vendeve të zhvilluara apo vendeve në zhvillim. Subvencionet mund të zbatohen drejtpërdrejt në prodhim, apo jo drejtpërdrejt,

---

<sup>8</sup> UNCTAD (1994)

në faktorët e prodhimit. Ato mund të zbatohen edhe në shërbimet financiare apo të transportit, në funksion të prodhimit apo të marketingut. Ato gjithashtu mund të

Tabela1 : Klasifikimi i masave jotarifore

<b>Grupi i masave</b>	<b>Masat jo tarifore për çdo grup</b>
<b>A. Masa për kontrollin e vëllimit të importeve</b>	Ndalim i importit; tipe të ndryshme të kufizimeve sasiore mbi importin; licensimi joautomatik; autorizimi i importit; kufizime vullnetare të eksportit (përfshirë edhe kufizimet vullnetare sipas Marrëveshjes Multifibër); +tregtimi shtetëror apo importimi i monopolizuar; kontrolle valutore dhe kontrolle të tjera financiare, kërkesa për përdorimin e inpueteve vendase, etj.
<b>B. Masa për kontrollin e çmimit të mallrave të importit</b>	(i) <i>Masa të tipit të tarifave:</i> Tarifa e ndryshueshme, tarifa sezonale; tarifa për kuota të caktuara (kuota tarifore); pagesa shtesë; pagesa të tjera të brendshme mbi importet; mbitarifa të ndryshueshme që synojnë barazimin e çmimit të importit me çmimin e brendshëm kufi; pagesa anti-dumping dhe pagesa kundërvepruese. (ii) <i>Masa të tjera jotarifore që lidhen me çmimin:</i> Çmime minimum (dysHEME) ose çmime reference, kufizim vullnetar i çmimit të importit, procedurat e prokurimit publik, procedura të tjera që rritin koston e importit (si kërkesa për depozitime paraprake pa pagesë interesash, etj).
<b>C. Masa monitoruese, që përfshijnë investigimin e çmimit dhe të vëllimit</b>	Licensimi automatik, mbikëqyrja e importeve, mbikëqyrja dhe investigimi i çmimeve, investigimi antidumping apo ai kundërveprues.
<b>D. Masa që lidhen me prodhimin dhe eksportin dhe +forma të tjera të ndërhyrjes qeveritare</b>	Subvencionet ndaj prodhimit dhe eksportit; ndalimet dhe taksat ndaj eksporteve; +sistemi kombëtar i taksimit dhe sigurimeve, politika makroekonomike, politika që lidhen me konkurrencën, me imigracionin, etj.
<b>+Procedurat doganore dhe praktikat administrative</b>	+Procedurat e klasifikimit doganor; procedurat e vlerësimit doganor; procedurat e zhdoganimit.
<b>E. Barriera teknike</b>	Rregullimet teknike dhe standardet për produktet që shiten në tregun e brendshëm dhe që zbatohen njësoj, në parim, edhe për produktet e importuara; kërkesat për marketing dhe paketim. Në këtë grup mund të përfshihen edhe masat sanitare dhe fitosanitare si dhe rregullat që lidhen me sigurinë. Gjithashtu këtu përfshihen masat për testim dhe certifikim. +Së fundi, këtu mund të përfshihen edhe masat rregullatore për publicitetin dhe mediat.

+Grupmasat apo masat e shtuara sipas klasifikimit të Tschäni and Wiedmer (2001).

zbatohen në rajone të caktuara, për të mbështetur zhvillimin e tyre. Subvencionet mund të marrin edhe formën e mbështetjes financiare apo lehtësimit tatimor. Ato mund të zbatohen edhe drejtpërdrejt mbi eksportet, duke marrë shpesh edhe formën e lehtësive tatimore. Ndikim të rëndësishëm në tregti, me synim mbrojtjen e interesave vendase (shpesh të grupeve të caktuara të interesit) por me pasoja në deformimin e raporteve të tregut, kanë edhe masat kufizuese ndaj eksportit.

Tschäni and Wiedmer (2001) në këtë grup masash identifikojnë edhe sistemin kombëtar të taksave dhe sigurimeve, politikat makroekonomike, politikat e konkurrencës, politikat e imigracionit, etj.

*Procedurat doganore dhe praktikat administrative*, të veçuara si grup masash nga Tschäni and Wiedmer (2001), megjithëse janë masa të nevojshme për përcaktimin e detyrimeve të importit për çdo produkt dhe për lejimin e hyrjes së tij në territorin doganor

të vendit, nëpërmjet frymës së rregullave përkatëse dhe mënyrës së zbatimit të tyre mund të rritin koston dhe të ngadalësojnë, të ndërlikojnë dhe pengojnë tregtinë. Tschäni and Wiedmer (2001, f. 10) nënvizojnë se si pengesë ndaj tregtisë paraqiten jo vetëm praktikata dhe procedurat administrative të lidhura drejtpërdrejt me zhdoganimin, *por edhe praktikata dhe procedurat administrative të lidhura me çdo mase tjetër jotarifore*. Në shkallën që rritet barra e shpenzimeve dhe e burokracisë që kërkohet për të plotësuar kërkesat që rrjedhin nga këto masa, vetë praktikata dhe procedurat përkatëse bëhen pengesa jotarifore në vetvete. Kjo ndodh më shpesh në vendet me institucione të dobëta, me ligje dhe rregulla të paqarta dhe jovepruese, dhe me shkallë të lartë korrupsioni.

*Masat teknike*, përfshirë rregullat teknike, standardet, masat për vlerësimin e konformitetit, si dhe masat sanitare dhe fitosanitare, megjithëse të nevojshme për ruajtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve, bimëve dhe për sigurinë kombëtare, mund të rritin çmimin e importit dhe të bëhen shkak për ndalimin e importeve që nuk pajtohen me to.

Klasifikimi i paraqitur në tabelën 1 bazohet në natyrën dhe në efektin kryesor të pritur të një mase, por ndarja e efekteve nuk mund të jetë e prerë. Për shembull, një tarifë nuk ka efekt thjesht në çmimin e mallit. Duke ndikuar në çmim, ajo njëkohësisht ndikon edhe në sasinë e importuar. Gjithashtu, po të konsideronim kufizimin e importit si synim të një mase jotarifore, atëherë klasifikimi i mësipërm i diferencon këto pengesa nga pikëpamja e mënyrës sesi ato e realizojnë këtë efekt. Megjithatë, këtu duhet të mbajmë parasysh se masat tarifore jo doemos dhe jo në çdo rast janë pengesa ndaj tregtisë.

Së fundi, për qëllime operative, shpesh konsiderohen të ashtuquajturat ‘masa thelbëzore jotarifore’ (core NTM), jo thjesht se konsiderohen me efekte më kufizuese ndaj tregtisë, por dhe sidomos se janë më të identifikueshme dhe më të matshme. Masat thelbëzore jotarifore klasifikohen në tre grupe kryesore<sup>9</sup>:

- (i) Masa të kontrollit të sasisë, përjashtuar kuotat tarifore dhe kufizimet specifike për ndërmarrje të caktuara.
- (ii) Masa financiare, përjashtuar masat që lidhen me konditat e pagesës, vonesat e transferimit, etj.
- (iii) Masa të kontrollit të çmimeve.

## 1.2 Matja e efekteve të pengesave jotarifore

Identifikimi dhe matja e efekteve të pengesave jotarifore është diskutuar gjerësisht në literaturë<sup>10</sup>. Matja e efekteve të pengesave jotarifore është një sipërmarrje e vështirë, krahasuar me matjen e efekteve të tarifave. Vështirësitë lidhen, para së gjithash, me natyrën e pengesave jotarifore, shumë nga të cilat është madje e vështirë të identifikohen si të tilla.

Vështirësitë lidhen edhe me llogaritjen e efektit tërësor të pengesave ndaj tregtisë. Jo rrallë mund të ndodhë që një pengesë tregtare të mos ketë asnjë efekt në tregti. Për shembull, në qoftë se mbi importin e një malli zbatohet një tarifë dhe njëkohësisht një kuotë, në rastin kur kuota është shumë e lartë, efektivisht vetëm tarifa vepron mbi mallin.

Në rastin e kuotave, ndodh shpesh që ato të mos plotësohen, siç është shembulli i shumicës së kuotave që BE i ka akorduar Shqipërisë në kushtet e rregjimit aktual të

<sup>9</sup> Shih Bora, Kuwahara and Laird, 2002, p.15.

<sup>10</sup> Shih, për shembull, Deardorf and Stern (1998), UNESCAP (2000), PECC (2001), etj.



tregtisë. Kështu ka ndodhur shpesh edhe me kotat e zbatuara në kuadrin e Marrëveshjes Multifibër mbi tekstilet dhe veshjet. Edhe në këtë rast duhet dalluar efekti real nga ai potencial i kuotës.

Gjithashtu, për të identifikuar efektet e plota të pengesave jotarifore do të duhej të mbaheshin parasysh edhe efektet e tyre në vendet partnere në tregti. Por, meqënëse shumë nga pengesat jotarifore janë diskriminuuese (kanë efekte të ndryshme në partnerë të ndryshëm tregtarë të vendit importues), llogaritja e plotë e efekteve të pengesave jotarifore bëhet një detyrë e vështirë.

Për identifikimin e rëndësisë së pengesave jotarifore dhe për matjen e efekteve të tyre, janë zhvilluar metodologji të ndryshme. Bora, Kuwahara and Laird (2002) përshkruajnë dy metoda kryesore, (i) metodën e inventarit, dhe (ii) metodën e modelimit. Përderisa kjo e fundit mbështetet në modele komplekse të simuluar, të cilat kërkojnë informacione paraprake për elasticitetet dhe efektet e çmimeve, autorët përshkruajnë edhe katër tregues kryesorë të efekteve të çmimeve: (a) ekuivalentin tarifor; (b) ekuivalentin e subvencioneve; (c) indeksin e kufizueshmërisë tregtare; dhe (d) mbrojtjen efektive. Më poshtë do të përshkruajmë shkurtimisht këto metoda dhe tregues.

#### *(i) Metoda e inventarit*

Kjo metodë synon të vlerësojë masën në të cilën tregtia është nën veprimin e pengesave jotarifore, ose shpeshësinë e zbatimit të këtyre pengesave në sektorë specifikë apo ndaj vendeve të veçanta. Për zbatimin i kësaj metode ndihmojnë të dhënat e UNCTAD mbi Treguesit e Kontrollit të Tregtisë<sup>11</sup>. Të dhënat përfshijnë zërat tariforë për të cilat zbatohen masa jotarifore, vendin apo vendet mbi të cilt veprojnë këto pengesa, dhe kohën e hyrjes në forcë dhe të shfuqizimit të këtyre pengesave. Burimi kryesor i të dhënave janë njoftimet në GATT dhe publikimet e qeverive. Të dhënat lidhen me më shumë se 100 kategori masash jotarifore (shih Aneks, tabela A1), por nuk përfshijnë masat që lidhen me eksportet dhe subvencionet.

Mbi bazën e metodës së inventarit, llogariten dy tregues, (i) norma e mbulimit të tregtisë (trade coverage ratio- $C_{jt}$ ), dhe (ii) indeksi i frekuencës (frequency index, ose transaction index- $F_{jt}$ ).

*Norma e mbulimit të tregtisë* ( $C_{jt}$ ), shpreh përqindjen e tregtisë që i nënshtrohet masave jotarifore në kohën  $t$  përkundrejt një vendi eksportues  $j$ , dhe jepet nga formula:

$$C_{jt} = \left[ \frac{\sum (D_{it} \cdot V_{iT})}{\sum V_{iT}} \right] \cdot 100 \quad (1),$$

ku:  $i$  përfaqëson linjën tarifore;  $V_i$  është vlera relative e importeve për artikullin  $i$ ,  $t$  është viti i matjes së pengesave jotarifore, ndërsa  $T$  përfaqëson vitin e përcaktimit të peshave të importit; dhe  $D_i$  është një variabël cilësor që merr vlerën 1 kur ndaj artikullit përkatës zbatohet të paktën një masë jotarifore dhe vlerën zero kur ndaj këtij artikulli nuk zbatohet asnjë masë jotarifore.

$C_{ij}$  merr vlera nga 0% në 100%. Vlerat ekstreme u takojnë përkatësisht rasteve kur nuk zbatohet asnjë masë jotarifore për asnjë nga artikujt, dhe kur zbatohet të paktën një

<sup>11</sup> UNCTAD Database on Trade Control Measures.

masë jotarifore për secilin prej artikujve, domethënë kur  $D_i$  merr vlerën 0 për çdo artikull  $i$ , dhe kur  $D_i$  merr vlerën 1 për çdo artikull  $i$ .

Përdorimi i normës së mbulimit të tregtisë shoqërohet me një problem interpretimi, që lidhet me endogjenitetin e peshave të vlerave të importeve. Masat jotarifore, duke reduktuar importet e mallrave përkatëse, reduktojnë edhe peshat relative të importit të tyre, gjë që pasqyrohet në uljen e normës së mbulimit. Në një rast ekstrem, në qoftë se një masë jotarifore është aq kufizuese sa të ndalojë plotësisht importin e artikullit  $i$  nga vendi  $j$ , pesha  $V$  e importit do të jetë zero, dhe norma e mbulimit të tregtisë do të ulet.

*Indeksi i frekuencës* ( $F_{jt}$ ), nuk vuan nga problemi i endogjenitetit të peshave vlerore të importeve. Ky indeks mban parasysh vetëm prezencën apo mungesën e masave jotarifore, pa iu referuar peshave vlerore të importeve. Megjithatë, edhe në këtë rast vlera e indeksit do të ndikohet nga rastet ekstreme kur masat jotarifore ndalojnë plotësisht importin e një malli nga një vend i caktuar. Indeksi i frekuencës shpreh përqindjen e transaksioneve të importit të mbuluara nga një grup i dhënë masash jotarifore, për një vend eksportues, dhe jepet nga formula:

$$F_{jt} = \left[ \frac{\sum (D_{it} \cdot M_{iT})}{\sum M_{iT}} \right] \cdot 100 \quad (2),$$

ku:  $M_i$  është një variabël cilësor (ashtu si  $D_i$ ) dhe tregon në se ka importe të artikullit  $i$  nga vendi  $j$ ; variablat e tjera shpejguese janë si në formulën (1).

Megjithë përparësinë në krahasim me normën e mbulimit të tregtisë ( $C_{jt}$ ) lidhur me problemin e endogjenitetit të peshave vlerore të importeve, indeksi i frekuencës ( $F_{jt}$ ) ka një dizavantazh në krahasim me treguesin e parë: duke mos pasqyruar vlerat relative të importeve të produkteve të ndikuara nga masat jotarifore,  $F_{jt}$  nuk na lejon të gjykojmë për rëndësinë e masave jotarifore për një eksportues në tërësi, apo relativisht sipas artikujve të importuar. Sidoqoftë, të dy treguesit shërbejnë për të matur kufizueshmërinë e tregtisë për shkak të masave jotarifore. Duke iu referuar Bora, Kuwahara dhe Laird (2002), në Aneks, tabela A2, jepet norma e mbulimit për një numër vendesh, referuar grup-produkteve të caktuara.

#### (ii) Metoda e modelimit

Metoda e modelimit përfaqëson një qëndrim më përfshirës për matjen e efekteve të pengesave tregtare dhe përdoret në studime empirike të ekuilibrit të pjesshëm apo të ekuilibrit të përgjithshëm, që lidhen me një vend apo një numër vendesh. Disa prej studimeve që përmenden më shpesh në literaturë, janë Venables and Smith (1998) që analizojnë efektet e heqjes së pengesave në tregtinë brenda Evropës; USITS (1989) dhe USITS (1990), që janë studime të Komisionit të Tregtisë Ndërkombëtare të SHBA dhe mbulojnë përkatësisht mallrat manufakturore, dhe mallrat bujqësore e burimet natyrore; Deardorf and Stern (1986) dhe Whalley (1985), që duke përdorur informacione mbi efektet e pengesave tregtare në çmime, ndërtojnë skenarë të efekteve të ndryshimit të pengesave tregtare përfshirë edhe liberalizimin e plotë të tregtisë, përkatësisht në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut (North American Free Trade Agreement-NAFTA) dhe Raundit të Uruguajt, duke u përqëndruar në mallrat bujqësore; etj.

Për modelimet simuluese, sikurse nënvizuar më sipër, një input i rëndësishëm është efekti në çmime i pengesave jotarifore. Për identifikimin e efektit të çmimeve, llogariten tregues të tillë, si ekuivalenti tarifor, ekuivalenti i subvencioneve, shkalla efektive e mbrojtjes, dhe indeksi i kufizimit të tregtisë.

#### *a. Ekuivalenti tarifor*

Ekuivalenti tarifor përfaqëson diferencën ndërmjet çmimit kombëtar të mbrojtur nga një masë jotarifore, dhe çmimit botëror në kushtet e tregtisë së lirë. Teknika e ekuivalentit tarifor, apo *e shtesës së çmimit* siç quhet ndryshe, përdoret shpesh në studimet e Bankës Botërore. Kjo metodë është përdorur gjithashtu në kuadrin e Raundit të Uruguajt për tarifimin e kufizimeve ekzistuese jotarifore në tregtinë e produkteve bujqësore. Por, në këtë rast procesi i tarifimit është kryer nga secila qeveri, sipas procedurave të rëna dakord nga palët, duke krahasuar çmimet c.i.f. të importeve me çmimin me shumicë (ex-factory) të mallrave identike të prodhuara në vend.

Llogaritjet e diferencës në çmime vështirësohen në rastet e heterogjenitetit të lartë të produkteve. Në raste të tilla mund të llogaritet çmimi mesatar i një numri produktesh që janë zëvendësues të afërt, por mund të përdoren edhe teknika ekonometrike për normalizimin e diferencave në karakteristikat cilësore të produkteve të diferencuara. Vështirësi mund të ketë edhe për identifikimin e çmimit botëror të tregut të lirë, që lidhen me luhatshmërinë e lartë të çmimeve të disa produkteve në tregjet ndërkombëtare, apo me subvencionimet e prodhimit dhe të eksportit për një numër produktesh. Në këto raste bëhen axhustimet përkatëse.

Diferencat në çmime mund të përftohen edhe drejtpërdrejt në një sistem ankandi për alokimin e kuotave të importit apo kuotave të eksportit.

Llogaritja e diferencave në çmime mund të realizohet edhe nëpërmjet modeleve ekonometrike, bazuar në ndryshimet e vrojtuar në vëllimet e prodhimit dhe të tregtisë, dhe duke përdorur elsticitete të njohura të kërkesës dhe të ofertës.

#### *b. Ekuivalenti i subvencioneve*

Ekuivalenti i subvencioneve ndaj prodhuesit (PSE) përfaqëson një tregues për matjen e transfertave qeveritare tek prodhuesit. Llogaritja e treguesit mbështetet në (i) identifikimin e shpenzimeve qeveritare që shkojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi te prodhuesit, dhe në (ii) llogaritjen e diferencës së çmimit aktual të brendshëm me çmimin e brendshëm në mungesë të ndërhyrjeve në tregti.

*Ekuivalenti i subvencioneve* mund të shprehet në mënyra të ndryshme, si ekuivalenti total i subvencioneve ndaj prodhuesit (PSE totale); ekuivalenti i subvencioneve për njësi (PSE për njësi); ekuivalenti relativ i subvencioneve ndaj prodhuesit (PSE relativ); koeficienti nominal i asistencës (NAC); dhe ekuivalenti i subvencioneve ndaj konsumatorit (CSE).

*Ekuivalenti total i subvencioneve ndaj prodhuesit (PSE totale)* përfaqëson thjesht vlerën e subvencioneve ndaj prodhuesve:

$$PSE = Q(P_d - P_w \cdot X) + D + I, \quad (3)$$

ku: Q përfaqëson sasinë e prodhuar;  $P_d$  dhe  $P_w$  janë përkatësisht çmimi i prodhuesit në monedhën vendase dhe çmimi botëror në njësi të valutës botërore; X përfaqëson kursin e këmbimit valutor; D përfaqëson pagesat qeveritare, pasi zbriten detyrimet që paguan

prodhuesi tek qeveria; dhe I përfaqëson transfertat jo të drejtpërdrejta përmes politikave të tilla, si subvencionimet e inputeve, mbështetja për marketingun ose ndërhyrjet në kursin valutor.

*PSE për njësi* ( $PSE_U$ ) llogaritet duke pjesëtuar PSE me sasinë e prodhimit:

$$PSE_U = \frac{PSE}{Q}$$

*PSE relative* ( $PSE_R$ ) llogaritet si raport, në përqindje, i PSE me vlerën e produkteve të shprehur me çmimet vendase, e axhustuar me vlerën e transfertave direkte:

$$PSE_R = \left[ \frac{PSE}{(Q \cdot P_d + D)} \right] \cdot 100 \quad (4)$$

*Koefiçenti i asistencës nominale* (NAC) është një mënyrë tjetër e shprehjes së PSE dhe llogaritet si raporti i shumës së çmimit botëror (të shprehur në njësi të valutës vendase) me  $PSE_U$  me çmimin botëror (të shprehur në njësi të valutës vendase):

$$NAC = \frac{(P_w \cdot X + PSE_U)}{P_w \cdot X} \quad (5)$$

Në thelb, NAC është shprehje relative e diferencës së çmimeve, e krijuar nga politikat subvencionuese. NAC mund të jetë pozitive ose negative. Në rastin e parë  $PSE_U$  është negative, duke nënkuptuar që efekti neto i politikave qeveritare ndaj prodhuesve në sektorin përkatës është negativ. Në rastin e dytë  $PSE_U$  është pozitive, duke pasqyruar një mbështetje neto të prodhuesve nga politikat qeveritare. Nga formula (5) shohim se vlera e NAC mund të ndryshojë edhe kur nuk ndryshojnë politikat qeveritare, mjafton që të ndryshojnë çmimet botërore apo kursi i këmbimit valutor.

#### *Ekivalenti konsumator i subvencioneve*

Ekivalenti konsumator i subvencioneve (consumer subsidy equivalent-CSE) mat taksën neto të nënkuptuar që rëndon mbi konsumatorët për shkak të masave mbështetëse ndaj sektorit, duke mbajtur parasysh edhe subvencionet ndaj konsumatorëve. Një CSE negative nënkupton që efektet e politikave të ndjekura në sektor paraqiten si një taksë neto mbi konsumatorët. Në thelb, NAC tregon masën në të cilën konsumatorët paguajnë më shumë nga sa do të paguanin në mungesë të ndërhyrjes qeveritare. Departamenti i Shteteve të Bashkuara i Shërbimit të Kërkimit Ekonomik për Bujqësinë llogarit dhe publikon rregullisht PSE dhe CSE për shumë mallra bujqësore në një numër të madh vendesh të zhvilluara dhe në zhvillim.

#### *c. Indeksi i kufizimit të tregtisë*

Indeksi i kufizimit të tregtisë (trade restriction index-TRI) përcaktohet si një 'ekuivalent tarifor uniform i deformimeve të konsumit dhe prodhimit' (Anderson and Neary, 1991). Ai paraqitet si një kombinim i 'PSE konsistente' dhe 'CSE konsistente', që përcaktohen si norma uniforme subvencionesh ekuivalente me kufizimin tregtar (humbjen në mirëqënie) të shkaktuar nga struktura aktuale e diferencuar e subvencioneve ose e

taksave. Indeksi i kufizimit të tregtisë kryesisht përdoret për të krahasuar dy situata të ndryshme të ndikuara nga politika ndërhyrëse, domethënë për të matur ndryshimin në kufizimin e tregtisë që vjen nga ndryshimi i politikave tregtare nga një periudhë kohore në tjetrën.

Përgjithësisht, TRI është më e zbatueshme në rastin e variacioneve të vogla, domethënë duke konsideruar periudha të shkurtra kohore apo ndryshime të vogla. Në rastin e indekseve hibride, që u referohen kufizimeve tarifore dhe kufizimeve kuotore të mallrave, krahasimi i tyre midis vendeve të ndryshme bëhet i vështirë. Për të evituar këtë vështirësi, përdoren ekuivalente tarifore të efektit të kuotave, dhe indeksi i rezultuar në këtë rast paraqitet si një 'faktor mbipagese i një tarife uniforme dhe një ekuivalenti tarifor' (Anderson and Neary, 1994).

#### *d. Mbrojtja efektive*

Treguesi i mbrojtjes efektive synon të japë efektin e kombinuar të mbrojtjes si mbi produktin, ashtu edhe mbi inputet që përdoren për prodhimin e tij. Në thelb, treguesi i mbrojtjes efektive mat vlerën e shtuar, në terma relativë, për shkak të mbrojtjes që gëzon industria përkatëse. Barazimi (6) shpreh një nga mënyrat matematikore të shprehjes së shkallës së mbrojtjes efektive (ERP):

$$t_e = \frac{(t_n - \sum a_i t_i)}{1 - \sum a_i}, \text{ ku} \quad (6)$$

ku:  $t_e$  përfaqëson shkallën efektive të mbrojtjes;  $t_n$  është norma e tarifës për produktin përfundimtar;  $t_i$  është norma e tarifës për inputin  $i$  të inportuar; dhe  $a_i$  është pjesa e inputit  $i$  në vlerën e produktit përfundimtar.

Shkalla e mbrojtjes efektive mund të përcaktohet duke iu referuar jo vetëm mbrojtjes tarifore, por edhe të gjitha formave të tjera të ndërhyrjes qeveritare, përfshirë edhe subvencionet.

Në qoftë se tarifa mesatare e inputeve është e njëjtë me tarifën mbi produktin, shkalla efektive e mbrojtjes del e njëjtë me tarifën mbi produktin. Shkalla efektive e mbrojtjes do të jetë përkatësisht më e madhe ose më e vogël se tarifa mbi produktin, kur kjo e fundit është më e madhe ose më e vogël se tarifa mesatare mbi inputet. Në rastin e dytë (kur tarifa mbi produktin është më e vogël se tarifa mesatare mbi inputet), shkalla efektive e mbrojtjes mund të jetë negative kur pesha e inputeve të importuara është mjaft e lartë (aq e lartë, sa emëruesi në anën e djathtë të barazimit (6) të bëhet negativ).

Pavarësisht nga problemet<sup>12</sup> që mund të përmbajë dhe nga vështirësitë e llogaritjes, sidomos në rastin e pengesave jotarifore, shkalla efektive e mbrojtjes përdoret gjerësisht nga ekonomistët, veçanërisht për të analizuar alokimin e burimeve. Duke filluar që nga fundi i viteve 1960-të, qeveritë kanë filluar të përdorin shkallën efektive të mbrojtjes për të vlerësuar efektet e mbrojtjes sektoriale në efikasitetin e alokimit të burimeve në sektorët e tjerë të ekonomisë. Shkalla e mbrojtjes efektive është bërë gjithashtu një instrument standard analize i Bankës Botërore lidhur me efektivitetin e huadhënies për axhustime

<sup>12</sup> Shkalla efektive e mbrojtjes është një instrument që përdoret në analizën e ekuilibrit të pjesshëm, pra është i papërshtatshëm për analiza në ekuilibrin e përgjithshëm. Gjithashtu, lihet mënjanë efekti i ndryshimeve teknologjike në diferencën e çmimeve kombëtare nga ato botërore. Një problem tjetër është se supozohet zëvendësueshmëri e plotë midis mallrave vendase dhe atyre botërore, që në shumë raste është larg realitetit.

sektoriale. Në qoftë se mbrojtja efektive për një sektor është më e ulët se shkalla mesatare e mbrojtjes në ekonomi, atëherë sektori në fjalë konsiderohet si sektor *i taksuar* në favor të sektorëve të tjerë të ekonomisë, dhe e kundërta. Ndodh kështu sepse në sektorët e mbrojtur më shumë ka një kërkesë më të lartë për faktorë, gjë që kushtëzon rritjen e çmimeve të këtyre faktorëve. Por rritja e çmimeve të faktorëve në këta sektorë ndikon në rritjen e çmimeve të faktorëve edhe në sektorin në fjalë, duke rritur koston në këtë të fundit.

Duke patur parasysh kufizimet lidhur me matjen e pengesave jotarifore dhe mbledhjen e të dhënave lidhur me to, Deradorf and Stern (1998) sygjerojnë një sërë parimesh bazë për matjen e barrierave jotarifore, disa prej të cilave janë:

- Matja e pengesave jotarifore duhet bërë në atë mënyrë, që të pasqyrojë ekuivalencën me tarifatat në termat e efekteve të tyre në çmimet vendase të mallrave të tregtuara.
- Për përcaktimin e ekuivalencës tarifore duhet të përdoren vetëm efektet e drejtpërdrejta.
- Përparësi duhet të kenë treguesit që rrjedhin nga studimi i rezultateve të tregut, në krahasim me treguesit e mbështetur në vlerësime të rezultateve të tregut, të bazuara në përpunimin e të dhënave sasiore.
- Vlerësimi i pengesave jotarifore duhet bërë duke u mbështetur në nivelet më të disagreguara të mundshme.
- Duke patur parasysh pasigurinë që ekziston lidhur me matjen e pengesave jotarifore, do të ishte e këshillueshme të ndërtoheshin intervale të përafërta sigurie lidhur me nivelet e pengesave jotarifore.

Lidhur me situatën në vendin tonë, ka pasur përçapje dhe janë bërë disa studime për identifikimin e pengesave jotarifore<sup>13</sup>, por ende mbetet shumë për të bërë, veçanërisht për matjen e efekteve të pengesave jotarifore. Ka shumë vështirësi që lidhen me mungesën e të dhënave, por mjaft prej treguesve të përshkruar në këtë pjesë të punimit janë relativisht të thjeshtë për t'u ndërtuar. Edhe Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT), pas këtij hapi të parë të një vështrimi të përgjithshëm mbi pengesat jotarifore dhe veçanërisht të pengesave teknike ndaj tregtisë, mund të fillojë të merret më konkretisht me problematikën që ajo paraqet.

---

<sup>13</sup> Ndër të tjera, Tschäni and Wiedmer (2001); Hemstead, Hemel (2004); Cottier, Bürgi, Wüger, and Foltea (2005); Messerlin and Mirdout, 2004.

## II. BARRIERAT JOTARIFORE DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Raundi i Tokios i GATT i viteve 1970-të shënoi hapin e parë në trajtimin shumëpalësh të pengesave jotarifore, por vetëm për disa kategori të këtyre pengesave u arritën marrëveshje. Marrëveshjet u sanksionuan në Kode, por aderimi në këto kode ishte jo i detyrueshëm. Raundi i Uruguajt shënoi një hap serioz përpara, duke rritur numrin e marrëveshjeve lidhur me NBT, duke i bërë ato të detyrueshme për të gjithë anëtarët dhe duke ia nënshtuar ato mekanizmit të zgjidhjes së konflikteve të OBT. Sot burimi kryesor i rregullave dhe praktikave që lidhen me masat jotarifore është Marrëveshja e OBT dhe mekanizmat e miratuara për zbatimin e këtyre rregullave në këtë organizatë. Disa nga pjesët kryesore të Marrëveshjes së OBT lidhur me pengesat jotarifore, janë:

- Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë 1994<sup>14</sup>
- Marrëveshja mbi Barrierat Teknike të Tregtisë
- Marrëveshja mbi Vlerësimin Doganor
- Marrëveshja mbi Rregullat e Origjinës
- Marrëveshja mbi Procedurat e Licensimit të Importeve.
- Marrëveshja mbi Bujqësinë (përfshirë Marrëveshjen mbi Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare)

Shqipëria, si anëtare e OBT që në vitin 2000, ka aderuar në GATT 1994, pra dhe në marrëveshjet e tjera shumëpalëshe që lidhen specifikisht me pengesat jotarifore. Në këtë pjesë të punimit do të paraqesim një përmbledhje të përmbajtjes së disa prej këtyre marrëveshjeve, si dhe raportin e Shqipërisë me to.

Marrëveshjet e OBT për pengesat jotarifore mishërojnë parimet kryesore ku mbështetet OBT (ashtu si edhe GATT-1947 para OBT), që janë (i) mosdiskriminimi; (ii) reciprociteti; (iii) detyrimi për zbatimin e angazhimeve; (iv) transparenca; dhe (v) mundësia për masa kufizuese të tregtisë në rretana të caktuara, i quajtur ndryshe si parimi i 'valvulave sigurorese'.

Megjithë rëndësinë e veçantë që ka marrë mbështetja e procesit të liberalizimit nëpërmjet kufizimit dhe heqjes së pengesave jotarifore, procesi i reduktimit të pengesave tarifore është gjithashtu i rëndësishëm dhe vazhdon të përbëjë një nga shtyllat e liberalizimit. Për më tepër, këto procese nuk mund të trajtohen të shkëputura.

### 2.1 Liberalizimi tarifor dhe qëndrimi ndaj kufizimeve sasiore

Lidhur me *tarifat*, procesi rregullues i OBT mbështetet në dy rregulla kryesore. *Së pari*, tarifatat duhet të jenë jodiskriminuese<sup>15</sup>. Përjashtimet kryesore nga MFN lidhen me situatat kur vendet (i) janë anëtare të marrëveshjeve integrale rajonale; (ii) ofrojnë preferenca tarifore në favor të vendeve në zhvillim, ose (iii) konfrontohen me importet nga një vend joanëtar. *Së dyti*, vendet anëtare nuk mund t'i rrisin tarifatat mbi nivelet e

<sup>14</sup> Quhet GATT 1994, për t'u dalluar nga GATT 1947.

<sup>15</sup> Parimi i mosdiskriminimit nënkupton *parimin e kombit më të favorizuar* (MFN) dhe parimin e *trajtitimit kombëtar*.

angazhimeve të tyre në kalendarin tarifor<sup>16</sup>. Sipas rregullave të GATT, çdo masë e ndërmarrë apo e mbështetur nga një qeveri, e cila ka efektin e nulifikimit apo keqësimit të koncensionit të nënkuptuar nga angazhimet tarifore, krijon shkak për ankesë nga partnerët tregtarë. Dhe për këtë nuk është e nevojshme të provohet ndonjë ndikim në tregti. Angazhimet jo vetëm kufizojnë mundësinë e rritjes së tarifave, por gjithashtu kufizojnë mundësinë e përdorimit të masave që kanë efekt ekuivalent.

Anëtarët e OBT-së janë të detyruar të kufizohen lidhur me përdorimin e pagesave apo taksave specifike të importit që kanë *efekt ekuivalent me tarifën*. Shembujt përfshijnë taksat mbi transaksionet në valuta të huaja, taksat e brendshme mbi importin, pagesat për shërbime që kanë efekt ndaj importuesve, dhe mbipagesa specifike lidhur me importet. Këto lloje pagesash njihen ndryshe si para-tarifë. *Para-tarifat* janë shpesh të rëndësishme në vendet në zhvillim. Të dhënat e një studimi të shtrirë në 41 vende në zhvillim në fillim të viteve 1980-të, provojnë se të paktën 1/3 e të ardhurave nga taksimi i importeve gjenerohej nga para-tarifat. Masa të tilla vuajnë shpesh nga zbatimi arbitrar dhe jotransparent (Kostecky and Tymosky, 1985). GATT 1994, në dallim nga GATT 1947, kërkon që natyra apo niveli i detyrimeve apo pagesave të tjera të rreshtohet përkrah linjave tarifore në kalendarin tarifor të secilit vend anëtar. Lejohet vendosja e detyrimeve apo pagesave, vetëm në qoftë se ato llogariten *mbi bazën e kostos së shërbimit përkatës* (Artikulli II:2c). Gjithashtu, Artikulli VIII (mbi pagesat dhe formalitetet që lidhen me tregtinë), kërkon që të gjitha pagesat për këto shërbime të 'kufizohen në nivelin e kostos së përafërt të shërbimit të ofruar dhe nuk duhet të përfaqësojnë një mbrojtje të tërthortë të produktit vendas, apo një taksim për importet apo eksportet për qëllime fiskale'. Shembujt të këtyre pagesave përfshijnë pagesat për veprimet konsullore, liçensimin, shërbimet statistikore, dokumentimin, çertifikimin, inspektimin dhe karantinimin e dezinfektimin.

Rregullat e GATT (përfshirë edhe GATT 1947) në parim e ndalojnë përdorimin e *kufizimeve sasiore*. Megjithatë, kufizimet sasiore gjetën një përhapje të gjerë gjatë disa dhjetëvjeçarëve përpara Raundit të Uruguajt, veçanërisht në produktet bujqësore, tekstilet dhe veshjet, dhe çelikut. Përgjatë viteve 1970-1980-të një përhapje të gjerë morën *kufizimet vullnetare të eksporteve* (VER), që shpesh ishin rezultat i negociatave pas kërcënimeve të masave antidumping. Raundi i Uruguajt e forcoi disiplinën lidhur me kufizimet sasiore, duke mos lejuar përdorimin e kufizimeve vullnetare të importit, duke vendosur tarifimin e kuotave bujqësore dhe duke përcaktuar një afat 10 vjeçar (deri në janar të viti 2005) për reduktimin deri në eliminim të kuotave për tekstile dhe veshje. Megjithë rënien e theksuar të përdorimit të formave tradicionale të kufizimeve sasiore, rastet e paraqitura në OBT për zgjidhje konfliktesh në këtë fushë kanë qenë ndër më të shpeshtat.

Korniza rregullatore e GATT lidhur me kufizimet sasiore, përmbledhet në Artikujt XI-XIV. Artikulli XI ndalon përdorimin e kufizimeve sasiore në parim, me përjashtim të produkteve bujqësore në qoftë se njëkohësisht janë marrë masa për kufizimin e produktit vendas. Artikulli XII lejon si përjashtim përdorimin e kufizimeve sasiore për shkaqe që lidhen me bilancin e pagesave. Artikulli XIII kërkon që kuota të zbatohet në parim mbi një bazë jodiskriminuese, dhe Artikulli XIV lejon që t'i kërkohej Këshillit të OBT-së që të pezullojë këtë kërkesë. Rregullave të mësipërme u duhet shtuar edhe Marrëveshja mbi

---

<sup>16</sup> Koncensionet tarifore që bëjnë vendet anëtare në kohën e anëtarësimit apo në negociatat periodike, shprehen në formën e angazhimeve tarifore në kalendarin tarifor të secilit vend anëtar (GATT, Artikulli 20)



Masat Siguruese (Safeguard Agreement), që ndalon përdorimin e kufizimit vullnetar të eksporteve.

Kufizimet sasiore përgjithësisht bëhen të mundura nëpërmjet *licensave*. Marrëveshja mbi Procedurat e Licensimit të Importeve, që ka fuqi mbi të gjithëa vendet anëtare të OBT-së, synon të forcojë rregullat e GATT-it në këtë fushë. Marrëveshja është e ngjashme me Kodin mbi Licensimin, që u negociua në Raundin e Tokios. Ajo përmban një numër kërkesash për rritjen e transparencës në sistemin e licensimit, përfshirë kërkesën për publikim, të drejtën e apelit të vendimit, dhe kërkesën për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së licensës. Si metoda të shpërndarjes së licensave mund të janë ajo tradicionale, e bazuar në pjesën historike të tregut të aplikantëve, ose metoda e bazuar në ankand (Hoekman and Kostecki, 2001).

## 2.2 Lehtësimi i procedurave të zhdoganimit

Procedurat e zhdoganimit kërkojnë vlerësimin dhe klasifikimin e importeve, me qëllim vendosjen e tarifave, përcaktimin e origjinës, realizimin e kontrollit valutor, dhe mbledhjen e statistikave. Procedurat doganore mund të bëhen pengesa jotarifore, në qoftë se klasifikimi apo caktimi i vlerës së mallrave bëhet në mënyrë të papërshtatshme. Qeveria (apo zyrtarët e saj) në mënyrë abuzive mund të përdorin procedura arbitrare doganore për të mbledhur të ardhurat që dëshirojnë, pavarësisht nga kalendari tarifor i negociuar formalisht. Gjithashtu, bizneset e konkuruara nga importi mund të korruptojnë zyrtarët doganorë, duke i nxitur këta të fundit të bezdisin në mënyrë të vazhdueshme importuesit. Për të kufizuar këto dukuri, GATT ka përcaktuar një sërë rregullash dhe parimesh që lidhen me klasifikimin dhe vlerësimin doganor. GATT ka përcaktuar gjithashtu një sërë rregullash që lidhen me kontrollin paraprak (para transportit) dhe me përcaktimin e origjinës së mallrave.

*Klasifikimi* është më pak shqetësues sesa vlerësimi doganor, sepse shumica e vendeve përdorin sisteme klasifikimi të pranura ndërkombëtarisht. Gjatë 40 viteve të para të ekzistencës së GATT-it, sistemet kryesore të klasifikimit të përdorura kanë qenë Nomenklatura Tarifore e Brukselit (Brussels Tariff Nomenclature-BTN) dhe Nomenklatura e Këshillit të Kooperimit Doganor (Customs Cooperation Council Nomenclatura-CCCN). Kohët e fundit është kaluar në përdorimin e Sistemit të Harmonizuar të Kodimit dhe Përshkrimit të Mallrave (Harmonized Commodity Description and Coding System, shkurt, Harmonized System-HS<sup>17</sup>). Shumica e vendeve anëtare të OBT përdorin Sistemin e Harmonizuar, pavarësisht në se janë nënshkruese të Marrëveshjes mbi HS ose jo. Sistemi i harmonizuar ndihmon për ta bërë mjedisin doganor më të parashikueshëm, por ky rol i tij kufizohet nga fakti që klasifikimi uniform shkon deri

---

<sup>17</sup> Këto sisteme klasifikimi janë zhvilluar nga Këshilli i Kooperimit Doganor, i shndërruar në Organizata Botërore e Doganave. Sistemi i Harmonizuar (HS) përmban 1.241 klasa (headings) të grupuara në 96 kapituj, dhe secili prej kapitujve është i ndarë në 21 seksione. Grupet (familjet) e produkteve identifikohen me një kod 4 shifror, ndërsa linjat e produkteve (nëngrupet), me kode 5 dhe 6 shifrorë. Zbatimi i HS mbështetet në një marrëveshje ndërkombëtare, e cila kërkon që aderuesit e saj ta zbatojnë sistemin në mënyrë uniforme në një nivel 6-shifror. Përtej nivelit 6 shifror, vendet mund ta axhustojnë sistemin e kodimit, bazuar në veçoritë e tyre. HS hyri në fuqi në vitin 1988 dhe u është nënshtruar rishikimeve periodike. Sistemi i Harmonizuar ka filluar të përdoret jo vetëm për qëllime doganore, por edhe për qëllime statistikore lidhur me tregtinë apo aktivitete të lidhura (si transporti dhe sigurimet).

në nivelin 6-shifror, ndërsa angazhimet sipas kalendarit tarifor të vendeve anëtare të OBT arrijnë në nivele 10 dhe 12-shifrore.

Rregullimi i vlerësimit doganor në GATT 1947 (Artikulli VII) nuk ka qenë shumë preciz, përderisa thjesht kërkohej që mallrat të vlerësoheshin mbi bazën e vlerës së tyre aktuale. Kodi mbi Shkeljet Doganore i negociuar në Raundin e Tokios, i cili precizonte kërkesat mbi vlerësimin doganor (pjesëmarrja në të cilin sikurse në të gjithë Kodet e negociuara në atë Raund ishte vullnetare), u bë i detyrueshëm për t'u zbatuar vetëm pas Raundit të Uruguajt. Marrëveshja mbi vlerësimin doganor (formalisht e njohur si Marrëveshja mbi Zbatimin e Artikullit VII të GATT), synon në vendosjen e standardeve uniforme, transparente dhe të drejta për vlerësimin e mallrave të importuara për qëllime doganore. Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje është të ofrojë një sistem që nuk lejon përdorimin e vlerësimeve arbitrare ose fiktive. Në parim, vlerësimi duhet të bazohet në vlerën e transaksionit, ose në vlerën e faturës së blerjes së mallit – që nënkupton çmimin aktualisht të paguar apo të pagueshëm për atë mall (të axhustuar për shpenzimet e transportit, apo shpenzime të tjera të ngjashme). Kjo metodë duhet zbatuar, kur

- (i) nuk ka ndonjë ndonjë kufizim të veçantë për disponimin apo përdorimin e mallit;
- (ii) blerësi dhe shitësi nuk janë të lidhur;
- (iii) asnjë e ardhur nga shitjet pasuese nuk shkon tek eksportuesi; dhe
- (iv) shitja dhe çmimi nuk varen nga kushte të atilla specifike, që e bëjnë të vështirë përcaktimin e këtij të fundit.

Marrëveshja nuk përcakton ndonjë sistem uniform lidhur me pagesat për transportin, sigurimet dhe ruajtjen. Secili vend mund të vendosë të bëjë vlerësim c.i.f. (kosto, siguri dhe transport), vlerësim kosto dhe transport, apo vlerësim bazuar vetëm në kosto (free-on-board –f.o.b). Në qoftë se autoritete doganore kanë arsye të besojnë se vlera e transaksionit është e pasaktë, atyre u kërkohet të zbatojnë, sipas radhës, pesë mundësitë e mëposhtme alternative të vlerësimit, duke u bazuar në:

- (i) vlerën e mallrave identikë;
- (ii) vlerën e mallrave të ngjashëm;
- (iii) të ashtuquajturën metodë deduktive;
- (iv) metodën e vlerës së llogaritur
- (v) metodën ‘në qoftë se të gjitha metodat e tjera dështojnë’.

Sipas Marrëveshjes, në qoftë se vlera vihet në dyshim nga dogana, barra e provës është në anën e importuesit.

*Inspektimi para transportit (pre-shipment inspection-PSI)* është një nga instrumentet që vendet përdorin për të lehtësuar tregtinë. Inspektimi para transportit (inspektimi paraprak) nënkupton kontrollin e mallrave nga firma të specializuara përpara se ato të transportohen për në vendin ku do të importohen. Inspektimi para transportit synon në reduktimin e hapësirës për importuesit apo eksportuesit për të përdorur fatura me vlerë më të lartë (në rastin kur tregtarët duan t'u shpëtojnë kontrolleve valutore) apo më të ulët (në rastin kur tregtarët duan t'i shmangen pagimit të plotë të detyrimeve doganore). Ai gjithashtu mund të synojë në kontrolle cilësore, që lidhen me standardet, rregullat teknike, etj.<sup>18</sup>.

Përdorimi nga qeveritë i PSI lidhet sidomos me paaftësinë e administratës doganore (tatimore) për të kryer aktivitetet e kërkuara. Ajo mund të reflektojë mungesën e

---

<sup>18</sup> Kontrolle të tilla zbatohen më shpesh sipas kontratave të lidhura midis blerësve dhe shitësve të produkteve të caktuara. Kontrollat paraprake të mandatuara nga qeveria lidhen kryesisht me sasinë dhe vlerën e mallrave që importohen në vend.

kapacitetit institucional, ose probleme që lidhen me aktivitete rentë-kërkuese dhe me korrupsionin.

Sipas Marrëveshjes së OBT mbi PSI, vendet që përdorin agjenci të specializuara duhet të sigurohen se aktivitetet PSI zbatohen në mënyrë objektive, transparente dhe jodiskriminuese. Gjithashtu, këto vende<sup>19</sup> duhet të ofrojnë procedura apelimi. Ankesat mund të paraqiten edhe në një Njësi të Pavarur, të ngritur sipas Artikullit 5 të Marrëveshjes PSI. Në studimet e ndryshme vlerësohet se PSI mund të jenë të dobishme në periudha afatshkurtra, por në periudha afatgjata ajo çka kërkohet është reformimi i thellë i doganave dhe forcimi institucional, në mënyrë që qeveritë ta menaxhojnë vetë procesin.

*Rregullat e origjinës* janë kritere që përdoren nga autoritetet doganore për të përcaktuar kombësinë e një produkti, apo një prodhuesi. Konventa Ndërkombëtare për Thjeshtimin dhe Harmonizimin e Procedurave Doganore, e vetmja konventë shumëpalëshe që merret me rregullat e origjinës dhe që është rishikuar pas bisedimeve të zgjatura në vitin 1998<sup>20</sup>, ofron një listë të shkurtër produktesh, që janë kryesisht produkte të bazuara në burime natyrore dhe që nuk përmbajnë materiale importi, të cilat duhet të konsiderohen si produkte të origjinuara në një vend të dhënë. Kur në prodhimin e një produkti përfshihen dy apo më shumë vende, vend i origjinës i produktit quhet ai, në të cilin ndodh transformimi i fundit substancial i produktit.

Transformimi quhet *substancial* kur ai i jep produktit karakterin e tij thelbësor. Për të përcaktuar në se një transformim është substancial, përdoren kritere të ndryshme, sikurse janë (i) ndryshimi i vendit të produktit në klasifikimin doganor; (ii) kalimi ose jo i produktit në operacione të caktuara përpunimi, që nënkuptojnë transformime substanciale; (iii) pesha relative e vlerës së materialeve shtesë të produktit; (iv) vlera e shtuar në vendin e transformimit të fundit.

Kritere të ndryshme mund të çojnë në rezultate të ndryshme dhe përcaktimi jo i qartë apo zbatimi jo korrekt i kritereve, mund t'i shndërrojnë rregullat e origjinës efektivisht në instrumente proteksioniste. Gjithashtu, vështirësitë në përcaktimin dhe zbatimin e këtyre kritereve mund të lenë shteg për veprime rentë-kërkuese dhe korruptive, të cilat rritin edhe më shumë pasigurinë për treguesit e mallrave.

Marrëveshja e WTO mbi rregullat e origjinës synon të nxisë harmonizimin e këtyre rregullave të përdorura nga vendet anëtare. Në vitin 1998 nga OBT u caktua një Komitet Teknik, i cili u ngarkua, në bashkëpunim me WCO, që të përcaktonte ndryshimet që sjellin 'transformimet substanciale' në klasifikimin e produkteve përkatëse në HS, në zbatim të kriterit të shënuar më sipër. Kur ky kriter nuk mund të zbatohet, Komiteti duhet të ofrojë udhëzime për përdorimin e kritereve të tjera. Marrëveshja mbi Rregullat e Origjinës specifikon gjithashtu që rregullat e origjinës të zbatuara ndaj produkteve të eksportit apo importit nuk mund të jenë më shtrënguese sesa ato të zbatuara për të përcaktuar në se një produkt është apo jo i prodhuar në vend (në përgjigje të nevojave që lidhen me procedurat antidumping, procedurat kundërvepruese, procedurat e sigurimit (safeguard) dhe ato të prokurimeve qeveritare). Rëndësia, por edhe problematika e rregullave të origjinës është rritur me rritjen e numrit dhe peshës së marrëveshjeve tregtare rajonale. Rregullat e harmonizuara të origjinës të WCO nuk kërkohet të zbatohen në marrëveshjet rajonale.

---

<sup>19</sup> Në vitin 1999 numëroheshin 35 vende në zhvillim, anëtare të OBT që përdornin shërbimet e agjencive PSI.

<sup>20</sup> Konventa Ndërkombëtare për Thjeshtimin dhe Harmonizimin e Procedurave Doganore njihet ndryshe si Konventa e Kiotos, ndërsa pas rishikimit në vitin 2000, ajo njihet si Marrëveshja e Rishikuar e Kiotos.

Duke konsideruar në përgjithësi problemet që lidhen me lehtësimin e procedurave doganore, veçanërisht për vendet në zhvillim, përfshirë edhe vendet në tranzicion si Shqipëria, prioritare mbetet nevoja e forcimit institucional të organeve doganore, e kompjuterizimit dhe e përdorimit të një sistemi të integruar informacioni, e këmbimit elektronik të informacionit me institucione të tjera të sistemit fiskal, e përdorimit të teknikave të vlerësimit të riskut, e përdorimit të sistemeve ex-post, të mbështetura në auditim, etj.

### 2.3 Rregullimi i subvencioneve dhe masave kundërvepruese

*Subvencionet dhe masat kundërvepruese* ndaj ndikimit të tyre në tregti, kanë qënë shpesh objekte konfliktesh. GATT 1947 nuk arriti as të japë një përkufizim të termit subvencion, as të përcaktojë tipet e subvencioneve që pengojnë tregtinë. Raundi i Uruguajt shënoi progres të rëndësishëm në të dy drejtimet.

*Së pari*, u arrit një marrëveshje për përkufizimin e subvencioneve. Sipas këtij përkufizimi, (i) subvencioni nënkupton një kontribut financiar të qeverisë (apo një institucioni publik), që do të thotë një transferim i drejtpërdrejtë aktual apo potencial i fondeve (granteve, huave, marrje në zotërim e aksioneve, ose garanci për huatë), të ardhura qeveritare të munguara, ose ofrimi apo blerja e produkteve që nuk i takojnë infrastrukturës së përgjithshme. (ii) Subvencioni përfshin gjithashtu rastet kur qeveria financon një institucion privat për të kryer një funksion që normalisht duhet të kryhet nga vetë qeveria. (iii) Në përcaktimin e subvencionit përfshihet edhe çdo formë e mbështetjes së të ardhurave apo çmimit. (iv) Në secilin rast, masa e marrë nga qeveria shoqërohet me një përfitim për marrësit e subvencionit. Përkufizimi i subvencionit është trupëzuar në Marrëveshjen mbi Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese (SCM) të OBT, e cila zbatohet për produktet jobujqësore. Për bujqësinë dhe tregtinë ka marrëveshje të posaçme.

*Së dyti*, Marrëveshja mbi Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese dallon tre kategori subvencionesh: (i) subvencione të pakundërveprueshme; (ii) subvencione të paluejshme; dhe (iii) subvencione të kundërveprueshme.

*Subvencionet e pakundërveprueshme* janë me përkufizim të lejueshme dhe ato nuk mund të kundërshtohen. Këtu përfshihen subvencionet *jo specifike*, përfitimet e të cilave nuk lidhen vetëm apo sidomos me firma, dege apo grupe degësh të caktuara. *Mosspecifikimi* kërkon që kriteret e subvencionit të jenë neutrale, jodiskriminuese, dhe horizontale (domethënë që të mos bëjnë dallim midis sektorëve). Në subvencionimet e pakundërveprueshme përfshihen edhe disa subvencionime specifike, në rastin kur ato mbështeten fort në argumentin e dështimeve të tregut dhe vetë subvencioni sjell përfitime të qarta publike. Të tilla subvencionime specifike përfshijnë subvencionimet e aktivitetit të kërkim-zhvillimit (R&D), ndihma për rajonet e pafavorizuara, subvencione që lidhen me mjedisin, etj.

Subvencionet që lidhen me performancën e eksporteve apo me përdorimin e produkteve vendase krahasuar me ato të importit, konsiderohen *subvencione të ndaluara*<sup>21</sup>. Të gjitha subvencionet mbi eksportet konsiderohen specifike, pavarësisht në se janë apo jo të orientuara për produkte apo industri të veçanta. Marrëveshja mbi Subvencionet shoqërohet nga një listë subvencionesh të ndaluara, siç janë shërbimet (përfshirë

---

<sup>21</sup> Nga ky rregull bëjnë përjashtim vendet më pak të zhvilluara.

transportin) që mund të përdoren për eksport produkteve në terma më të favorshme se mallrat e konsumuara në vend. Në listë përfshihen gjithashtu kreditimi, garantimi, apo sigurimi i eksporteve me një kosto më të ulët se ajo e tregut. Përjashtim bëjnë rastet kur vendet zbatojnë kriteret e kreditimit të eksporteve, të parashikuara në marrëveshjen përkatëse të OECD. Konkensionet tatimore mbi të ardhurat nga eksporti konsiderohen gjithashtu subvencione mbi eksportin. Në qoftë se sipas panelit të zgjidhjes së konflikteve një vend anëtar i OBT është duke zbatuar një subvencionim eksporti, zakonisht masa e marrë do të jetë që vendi të heqë subvencionin brenda një periudhe prej 3 muajsh.

*Subvencionet e kundërveprueshme*, që bëjnë pjesë në kategorinë e tretë, janë subvencione të lejueshme, por lidhur me to vendet e tjera anëtare të OBT mund të zbatojnë masa kundërvepruese kur gjykojnë se këto subvencione kanë efekte negative mbi to. *Efekte negative* konsiderohen dëmtimi i një industrie vendase, nulifikimi apo zvogëlimi i efektit të konkencioneve tarifore sipas kalendarit të angazhimeve tarifore, dhe kërcënimi apo ndikimi serioz në interesat e vendit. *Kërcënimi apo ndikimi serioz* në interesat e vendit përcaktohet si një kërcënim që vjen nga një subvencion total i një produkti që kalon 5% të vlerës së tij, dhe përdoret për të mbuluar humbjet operuese të firmës apo industrisë, apo merr formën e faljes së borxheve ndaj qeverisë. Kërcënimi serioz mund të ndodhë në qoftë se subvencioni redukton eksportin e vendeve anëtare të OBT, ose rezulton në një ulje të konsiderueshme të çmimeve apo në një rritje të pjesës së tregut të vendit subvencionues për një produkt primar. Në qoftë se një subvencion i kundërveprueshëm ka një efekt negativ ndaj një vendi anëtar, ky i fundit mund të kërkojë konsultime me vendin subvencionues. Në qoftë se konsultimet dështojnë, vendi mund të kërkojë një panel zgjidhjeje konflikti brenda 60 ditësh.

Vendet anëtare janë të detyruara të dërgojnë programin e tyre të subvencioneve në sekretariatit e OBT-së çdo vit, duke dhënë informacion mbi tipin e subvencionit, masën e tij, objektivat politike, kohëzgjatjen e parashikuar, si dhe statistikën që bëjnë të mundur përcaktimin e efektit të tij në tregti. Gjithashtu, çdo vend anëtar mund të njoftojë vendet e tjera lidhur me një subvencion të mundshëm nga një vend i tretë, në qoftë se vendi subvencionues nuk e ka bërë këtë njoftim.

Dy momente për t'u shënuar lidhur me rregullimin e subvencioneve nga OBT: *Së pari*, si kriter për të gjykuar ndikimin e një subvencionit shërben vetë *masa e subvencionit*, dhe jo dëmi që u shkaktohet partnerëve tregtarë, për shkak të avantazhit të lehtësisë së llogaritjes. *Së dyti*, masat korrigjuese ndaj subvencioneve kanë ardhur duke u shtrënguar. Për shembull, në rastin e subvencioneve të ndaluara, në vend të kërkesës për heqjen e subvencionit, panelet kanë kërkuar ripagimin e subvencionit nga firmat përfituese.

#### *Trajtimi i veçantë i vendeve në zhvillim dhe vendeve në tranzicion*

Nën GATT-1947 vendet në zhvillim ishin të lira të subvenciononin eksportet, ndërsa Raundi i Uruguajt i ngushtoi mjaft këto mundësi. Megjithatë, Artikulli 27 i Marrëveshjes mbi Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese parashikon një serë përjashtimesh apo rregullash më të zbutura për vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion.

Për vendet e përfshira në proces *tranzicioni* drejt një ekonomie tregu, lehtësimet konsistojnë në dy drejtime. *Së pari*, deri në vitin 2002 këto vende mund të aplikojnë për programe subvencionesh të ndaluara. *Së dyti*, gjatë së njëjtës periudhë programet e subvencioneve që përfshinin falje detyrimesh nuk konsideroheshin të kundërveprueshme.

Vendet në zhvillim me të ardhura vjetore për frymë nën 1000 dollarë amerikanë, përjashtohen nga ndalimi i subvencionimit të eksportit. Sapo kalojnë këtë nivel, këto vende duhet të eliminojnë subvencionet e ndaluara brenda një periudhe 8 vjeçare. Vendeve të tjera në zhvillim të palistuara në Aneksin e Marrëveshjes mbi Subvencionet, u kërkohet të eliminojnë subvencionet mbi eksportet brenda 8 vjetëve, duke filluar nga viti 1995. Vendeve në zhvillim nuk u ndalohet gjithashtu të zbatojnë subvencionime që janë të kondicionuara nga përdorimi i produkteve vendase për një periudhë 5 vjeçare, periudhë që rritet në 8 vjet në rastin e vendeve më pak të zhvilluara, me të drejtën për të kërkuar shtyrje afati. Shtyrja e afatit bëhet vjetore, mbi bazën e konsultimeve me Komitetin e Subvencioneve. Ndërkaq, vendet në zhvillim që bëhen konkurrese në një produkt (që do të thotë që kanë kapur 3,25% të tregut global), duhet të eliminojnë çdo subvencion brenda 2 vjetëve.

Qëndrimi ndaj subvencioneve vazhdon të jetë një objekt diskutimi teorik dhe politik në literaturë, veçanërisht kur është fjala për vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion. Argumenti kryesor në favor të subvencioneve në përgjithësi është nevoja e ndërhyrjeve publike për të korrigjuar dështimet e tregut, ndërsa argumenti kryesor për subvencionimin e eksporteve lidhet me eksternalitetet pozitive që shoqërojnë këto subvencione. Subvencionimi i eksportit të produkteve jotradicionale nëpërmjet, për shembull, mbështetjes së marketingut, supozohet të ketë efekte pozitive edhe në eksportuesit e pasubvencionuar. Subvencionimi i eksportit mund të ketë gjithashtu efekte pozitive në rastin e veprimtimit të faktorëve që frenojnë eksportet, siç mund të jetë rasti i mbivlerësimit të valutës vendase. Së fundi, programet e subvencionimit të eksporteve marrin një dimension të rëndësishëm politik, në kuadrin e strategjisë së përgjithshme që mund të ndjekë një vend për nxitjen e eksporteve (Bhagwati, 1998).

Shumë vende përdorin programe të nxitjes së eksporteve, që përfshijnë asistencën për të depërtuar në tregje të reja përmes organizimit të panairëve tregtare, fushatave të përgjithshme marketing lidhur me imazhin e vendit apo të produkteve të eksportit, rolit të atashëve tregtarë në ambasada apo konsullata, etj. Gjatë viteve 1990-të përhapje të gjerë patën skemat e pjesëmarrjes së qeverive në financimin e kostos së programeve që lidheshin me përmirësimin e pajisjeve prodhuese, marrjen e çertifikatës ISO 9000 të sistemeve të menaxhimit, zbulimin e tregjeve të reja, etj. Këto programe mund të konsiderohen si subvencione, në qoftë se mbështetja e dhënë është proporcionale me eksportet, por ato mund të konsiderohen edhe thjesht si programe zhvillimi.

Hoekman and Kostecki (2001) tërheqin vëmendjen se shpesh burimi i problemit që synohet të zgjidhet me ndihmën e subvencioneve, mund të jetë i lidhur me politikat e ndjekura. Në këtë rast, subvencionin do të ishte një zgjidhje 'second best', që do të thotë se të tjera zgjidhje 'first best', që do të merreshin drejtpërdrejt me burimin e problemit, do të ishin më efektive dhe më eficiente. Për më tepër, shpesh, politikat e subvencionimit janë të nxitura nga grupet e interesave rentë-kërkuese. Ndërsa subvencionimi i produkteve në rastet e dështimit të tregut do të paraqitet si mënyra më efiçente për të kufizuar dhe eliminuar eksternalitetet negative, i orientuara nga rishpërndarja e të ardhurave subvencionimi do të ndikonte negativisht në operimin e tregjeve. Në këto kushte, disiplina më e fortë ndaj subvencionimeve e rezultuar nga Raundi i Uruguajt, paraqitet e dobishme.

## **2.4 Rregullimet teknike dhe standardet**

Për funksionimin e ekonomive moderne, janë shumë të rëndësishme standardet e produkteve, rregullat teknike dhe sistemet e çertifikimit. Standardet janë zakonisht vullnetare dhe përgjithësisht të përcaktuara nga industria apo institucione standardizimi joqeveritare, ndërsa rregullat teknike janë ligjërisht të detyrueshme dhe zakonisht synojnë në mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe kafshëve. Sistemet e çertifikimit përfshijnë procedurat e vlerësimit të konformitetit të produkteve apo të proceseve të prodhimit me standardet dhe rregullat teknike përkatëse.

Standardet janë përgjithësisht të nxitura nga tregu. Firmat që dëshirojnë të eksportojnë apo të shesin në një treg, kanë nxitje të forta për të plotësuar standardet mbizotëruese për të rritur aftësitë e tyre konkurruese dhe për të sinjalizuar që produktet i kënaqin normat minimale të cilësisë. Si në rastin e standardeve ashtu edhe në rastin e rregullave teknike, normat përcaktohen nga organizma të specializuara ndërkombëtare. Një institucion i rëndësishëm në këtë fushë është Organizata Ndërkombëtare e Standardeve (ISO), me qendër në Gjenevë.

Rregullimet teknike dhe standardet (TRS) përgjithësisht konsiderohen si instrumente të rritjes së mirëqënies. Por, ato mund të përdoren e dhe si mjete të pengimit të tregtisë. Dy çështje janë të rëndësishme lidhur me përdorimin e TRS: sigurimi në se masa përkatëse ka efekte diskriminuese në tregti, dhe përcaktimi në se kjo masë është e nevojshme për të arritur objektivat e qeverisë.

Argumenti ekonomik për TRS qëndron në dështimet (papërsosmëritë) e tregut, të tilla si asimetria e informacionit, pasiguria, fuqia tregtare, dhe eksternalitetet në prodhim dhe në konsum. Standardet, në përgjithësi kanë karakteristikat e një të mire publike, në kuptimin që përdorimi i tyre nga një subjekt nuk pakëson mundësitë e konsumit të për subjekte të tjerë. Për më tepër, rritja e masës së përdorimit të tyre sjell rritjen e përfitimeve të përdoruesve, në termat e uljes së kostove të transaksionit. Megjithatë, shumica e standardeve priren të jenë të mira publike jo të pastra, në kuptimin që mund të sjellin përfitime më të mëdha për grupe të caktuara, të identifikueshme. Në masën që zhvillimi i një standardi shoqërohet me kosto, mund të ketë nxitje për 'përfitime pa pagesë' (free riding), prandaj mund të kërkohej edhe ndërhyrja qeveritare për arritjen e standardeve të përbashkëta.

Standardi mund të ndihmojë në arritjen e efikasitetit teknike, por ai mund të shoqërohet edhe me rritjen e fuqisë tregtare të firmave ekzistente në degë. Standardet mund të përdoren prej tyre si pengesë për hyrjen e firmave të reja në degë.

Përderisa mund të rritin koston e prodhimit, TRS mund të pengojnë tregtinë ndërkombëtare. Roli i tyre pengues ndaj tregtisë rritet, në qoftë se TRS ndryshojnë nga një vend në tjetrin, duke sjellë segmentimin e tregut.

Cilat janë kërkesat e OBT ndaj TRS?

OBT nuk kërkon që vendet të kenë standarde produktesh. Gjithashtu, OBT nuk zhvillon standarde. Synimi kryesor i Marrëveshjes TBT të GATT 1994<sup>22</sup> është që rregullimet e detyrueshme teknike, standardet vullnetare dhe testimi e çertifikimi i produkteve të mos përbëjnë pengesa të panevojshme për tregtinë.

Disa nga rregullat kryesore që disjelojnë përdorimin e TBT nga vendet anëtare, janë (i) mosdiskriminimi, (ii) moskufizimi i tregtisë më shumë nga sa është e nevojshme për të plotësuar objektivat legjitime<sup>23</sup> (iii) mbështetja në standarde, rregullime teknike dhe

<sup>22</sup> Një nga Kodet e Raundit të Tokios merrej pikërisht me TBT.

<sup>23</sup> Objektiva legjitime konsiderohen sigurimi kombëtar, parandalimi i praktikave mashtruese, dhe mbrojtja e shëndetit apo sigurisë së jetës së njeriut, kafshëve dhe bimëve, si dhe mbrojtja e mjedisit.

procedura të vlerësimit të konformitetit, të zhvilluara nga institucione ndërkombëtare, dhe (iv) transparenca.

#### *Reduktimi i kostove të transaksionit: harmonizimi dhe njohja reciproke*

Vlerësohet se mbi 60% e eksporteve amerikane u nënshtrohen rregullave teknike lidhur me shëndetin, sigurinë, etj., në tregjet e destinimit të tyre. Brenda EU, 75% e vlerës së tregtisë së mallrave u nënshtrohen rregullimeve teknike të detyrueshme (Hoekman and Kostecki, 2001). Sipas vlerësimeve të Unter (1998), procedurat e testimit dhe vlerësimit të konformitetit të përbëlluara nga Hewlett Packard u gjashtëfishuan brenda periudhës 1990-1997. Rregullat e GATT ndihmojnë për mosdiskriminimin dhe rritjen e transparencës, por përsëri kostot e transaksionit mbeten të larta për shkak të procedurave të shumta. Mënyra më efektive për uljen e kostove të transaksionit janë *harmonizimi* dhe *njohja reciproke*.

*Harmonizimi* realizohet nëpërmjet adoptimit nga një vend i rregullave teknike të një vendi tjetër, ose nëpërmjet negociatave për arritjen e rregullave të përbashkëta. Praktika jep më shumë shembuj nga mënyra e parë, e nxitur nga pabarazia e përmasave të tregjeve. Për shembull, Zvicra ka adoptuar TRS të BE, për të bërë të mundur hyrjen dhe qarkullimin e mallrave zviceriane në tregjet e BE-së pa pengesa që mund të lidheshin me TRS-të.

Marrëveshjet e *njohjes reciproke* paraqiten si një zëvendëues praktik dhe efektiv i marrëveshjeve për harmonizimin e TRS mbi baza konsensusi, të cilat janë të vështira për t'u arritur, veçanërisht kur është fjala për një grup vendesh. Megjithatë, edhe marrëveshjet e njohjes reciproke mund të kërkojnë një shkallë harmonizimi veçanërisht lidhur me rregullat teknike të detyrueshme. Efektiviteti i njohjes reciproke në uljen e kostove të transaksionit dhe në nxitjen e konkurrencës është provuar në rastin e BE-së.

Një “pikë e dobët” e procesit të njohjes reciproke është se ai mbështet fort në besimin reciprok lidhur me kompetencën dhe aftësinë e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e rregullave të detyrueshme dhe në gatishmërinë për të qenë fleksibël në vendosjen e standardeve minimale. Për vendet në zhvillim, apo edhe për vende në tranzicion si Shqipëria, do të kërkohej një forcim i rëndësishëm institucional në mënyrë që vendet e zhvilluara partnere të pranojnë “mbikqyrjen vendase”. Më shumë të ngjarë ka që si zgjidhje të pranohet kryerja e vlerësimit të konformitetit nga një pale të tretë.

## **2.5 Masat sanitare dhe fitosanitare**

Masat sanitare dhe fitosanitare (SPS) janë kërkesa që imponohen nga qeveria për të bërë të mundur sigurinë e produkteve për konsum nga njerëzit dhe kafshët, ose për të mbrojtur mjedisin (jetën e bimëve). Shumica e qeverive përcakton standardet minimale që produktet, bimët dhe kafshët duhet të plotësojnë, për t'u lejuar që të hyjnë në territorin e tyre. Zakonisht këto norma zbatohen në mënyrë të njëjtë për produktet, kafshët dhe bimët e huaja apo ato të prodhuara në vend. Por, zbatimi i ndryshëm i tyre i shndërron ato në pengesa ndaj tregtisë. Diferencime të tilla u bënë predominuese gjatë viteve 1980-të. Si rezultat i negociatave në Raundin e Uruguajt, u arrit Marrëveshja mbi Aplikimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare, si pjesë e Marrëveshjes mbi Bujqësinë. Masat SPS përfshijnë të gjitha rregullimet dhe procedurat, përfshirë kriteret e produkteve; metodat e përpunimit dhe prodhimit; procedurat e testimit, inspektimit, certifikimit dhe aprovimit; trajtimet në karantinë; ofrimin e procedurave të përshtatshme statistikore dhe të metodave të vlerësimit



të riskut; dhe kërkesat për paketim dhe etiketim që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e ushqimit.

Ashtu si në rastin e rregullimeve teknike dhe standardeve të produkteve, nuk ka asnjë kërkesë nga OBT që anëtarët të përshtasin masa SPS. OBT nuk përcakton norma SPS. OBT thjesht vendos disiplinë, në rast se vendet anëtare zbatojnë masa SPS. Por, vendet anëtare të OBT janë të detyruara të njoftojnë sekretariatit e OBT për ndryshimin e masave SPS dhe njëkohësisht të motivojnë ndryshimin.

Sipas Marrëveshjes SPS, vendet anëtare *nuk mund të diskriminojnë* në mënyrë të pajustificueshme midis vendeve anëtare të OBT; masat sanitare dhe fitosaniatave *nuk mund të jenë më kufizuese* sesa kërkohet për të arritur objektivat e tyre; dhe ato *nuk mund të përbëjnë një kufizim të maskuar* në tregtinë ndërkombëtare. SPS duhet të mbështeten në standardet, udhëzimet ose rekomandimet ndërkombëtare, kur ekzistojnë të tilla, ose në masa alternative në se provohet në mënyrë shkencore. Një kërkesë e rëndësishme e Marrëveshjes është që masat SPS të mbështeten në *parime shkencore*, përfshirë vlerësimin e riskut për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mbështetur në teknikat e vlerësimit të riskut të zhvilluara nga organizatat ndërkombëtare përkatëse.

Një nevojë themelore për vendet në zhvillim në fushën e SPS-ve është të forcojnë institucionet që lidhen me standardet, përfshirë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, dhe të zhvillojnë mekanizmat për të reduktuar kostot e transaksionit. Një rol në këtë drejtim mund të luajë sektori privat, përmes inspektimit para transportit dhe programeve të certifikimit.

## 2.6 Masat që ndikojnë në investimet që lidhen me tregtinë

Rritja e vullshme që kanë shënuar investimet e huaja direkte<sup>24</sup> (FDI) shpjegohet, ndër të tjera, edhe me liberalizimin e regjimeve të FDI në shumë vende. Megjithatë, ndërsa shumë vende bëjnë përpjekje për tërheqjen e FDI, mjaft vende vazhdojnë të lidhin veprimtarinë në to të shoqërive shumëkombëshe me kushtëzime që lidhen me tregtinë, të quajtura ‘masa investimesh që lidhen me tregtinë (trade-related investment measures-TRIMs), sikurse janë kërkesat për ‘përmbajtje lokale’<sup>25</sup>, kërkesat për eksport, apo për transferim teknologjie. Jo rrallë ndodh që masat për nxitjen e investimeve të shoqërohen me kërkesa performance dhe masa të tjera kufizuese ndaj tyre. TRIMs janë më të përqëndruara në industri të caktuara, si industria e automobilave, industria kimike dhe petrokimike, industria e kompjuterave, etj.

Nga pikëpamja ekonomike, TRIMs përgjithësisht konsiderohen joefiçente. Për shembull, masa e ‘përmbajtjes lokale’ vepron si një tarifë mbi produkte të ndërmjetme, ose e ashtuquajtura ‘kërkesë për të balancuar tregtinë që synon kufizimin e importit në një sasi të dhënë’, vepron si një kuotë. Ndërkaq, këto masa janë inferiore në krahasim me një tarifë ekuivalente, për shkak se qeveria nuk merr të ardhurat që do t’i merrte në rastin e tarifës.

Edhe argumenti ekonomik mbi nevojën e ndërhyrjes me anë të TRIMs për të korrigjuar shtrembërimet apo eksternalitetet që rrjedhin nga FDI, është i diskutueshëm. Në

<sup>24</sup> Vlerësohet se shitjet e filialeve të shoqërive shumëkombëshe tashmë e kalojnë vlerën totale të eksporteve globale të mallrave dhe shërbimeve (Hoekman and Kosteci, 2001).

<sup>25</sup> Që do të thotë që produkti i prodhuar nga një shoqëri e huaj të përmbajë jo më pak se një nivel i caktuar (në përqindje), inpute të prodhuara në vend. Kjo përbën dhe masën më të përhapur investuese që lidhet me tregtinë.

kushtet e konkurrencës së plotë TRIMs, për shembull rregulli i ‘përmbajtjes kombëtare’, ul mirëqënien, përderisa rrit kërkesën, pra edhe çmimin e inputit të prodhuar në vend. Ndërkaq, përfitimet e zotëruesve të këtyre inputeve balancohen nga humbjet që rrjedhin nga rritja e çmimit të produktit. Në kushtet e konkurrencës jo të plotë, efektet në mirëqënie të këtyre masave mund të rezultojnë pozitive (Richardson, 1993), por në këtë rast ato do të ishin inferiore në krahasim me masa më të tjera që do të nxisnin drejtpërdrejt konkurrencën.

Duke qenë një çështje shumë e debatuar në negociatat e Raundit të Uruguajt, Marrëveshja e arritur mbi TRIMs nuk është shumë ambicioze. Në parim, rregullat e parashikuara në këtë marrëveshje nuk shkojnë përtej rregullave ekzistuese të GATT. Marrëveshja kryesisht ndalon masat që nuk pajtohen me parimin e GATT të trajtimit kombëtar dhe me ndalimin e parashikuar në GATT të përdorimit të kuotave. Marrëveshja përfshin një listë të masave të ndaluara, si ‘përmbajtja lokale’, balancimi tregtar, balancimi valutor, dhe kërkesat për shitje në tregun e brendshëm. Ndërkaq, politikat që binin ndesh me të duhet të notifikoheshin brenda 90 ditëve me hyrjen në forcë të Marrëveshjes dhe të eliminoreshin brenda 2, 5, dhe 7 viteve, përkatësisht për vendet e zhvilluara, vendet në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara. Për shkak të vazhdimit të debatit, veçanërisht kundërshtimeve që vijnë nga ana e vendeve në zhvillim dhe kërkesve të tyre për shtyrje të afateve, Marrëveshja TRIMs është lënë të diskutohet në raundin në vazhdim të negociatave<sup>26</sup>.

## 2.7 NTB dhe zhvillime sektoriale

Në parim, rregullat e GATT mbi mosdiskriminimin, transparencën, detyrimin për të respektuar angazhimet tarifore, etj., shtrihen mbi të gjithë sektorët. Në praktikë, presionet specifike që vinin nga disa sektorë rezultuan në një trajtim specifik të këtyre sektorëve. Dy nga këta sektorë të prodhimit të mallrave janë bujqësia, dhe tekstilet e veshjet. Këta sektorë praktikisht dolën jashtë sferës rregulluese të GATT 1947, dhe u përfshinë në këtë sferë vetëm në Raundin e Uruguajt. Marrëveshjet e arritura për këta sektorë kanë filluar zbatimin e tyre të plotë vetëm në fillim të vitit 2005. Njohja me përmbajtjen e marrëveshjes së OBT për sektorin e tekstileve dhe veshjeve do të ishte e rëndësishme edhe për vendin tonë, po të mbajmë parasysh peshën e këtij sektori veçanërisht në eksportet shqiptare dhe prirjen e dëshiruar të rritjes së vlerës së shtuar të eksporteve shqiptare nga ky sektor, deri tani të dominuara nga riekporti. Megjithatë, për shkak të peshës së madhe të prodhimit bujqësor në ekonominë shqiptare, dhe të peshës edhe më të madhe të punëzënies bujqësore në punëzënie totale dhe të popullsisë agrare në popullsinë totale, më poshtë do të qëndrojmë në mënyrë të posaçme në zhvillimet sektoriale në bujqësi.

### *NTB dhe Bujqësia*

Bujqësia është një nga sektorët që është dalluar për ndërhyrjen shtetërore si në vendet në zhvillim, ashtu edhe në vendet e zhvilluara. Argumentet që qëndrojnë në bazë të ndërhyrjes qeveritare lidhen me rritjen e të ardhurave të fermerëve, garantimin e ushqimit

---

<sup>26</sup> Faktikisht, problemet që lidhen me investimet, ashtu sikurse të gjitha “Çështjet e Singaporit” pjesë e të cilave janë edhe investimet, janë hequr nga axhenda e raundit të Dohas, por duke mbetur në axhendën e OBT.

për popullsinë, përmirësimin e bilancit të pagesave, etj. Karakteristikë është se, ndërsa në vendet në zhvillim ndërhyrja ka marrë kryesisht formën e taksimit të bujqësisë dhe subvencionimit të konsumit të ushqimit në popullsinë urbane, në vendet e zhvilluara ajo është realizuar më shumë si subvencionim i bujqësisë. Për më tepër, vendet e zhvilluara priren të jenë më proteksioniste lidhur me bujqësinë, ndërsa vendet në zhvillim shpesh janë të detyruara të nxisin importin e produkteve bujqësore.

Ky ndryshim thelbëzor në politikat ndërhyrëse lidhet me dallimet strukturore në ekonomi, në punëzënie dhe në konsum. Në vendet e zhvilluara produkti bujqësor ze një peshë mjaft të vogël në kuadrin e PBB, po kështu edhe popullsia e zenë me punë në bujqësi në raport me punëzënie në përgjithësi dhe pesha e ushqimeve në shportën e konsumatorit. Në vendet në zhvillim raporti është i përmbysur. Në këto kushte, efektet e një politike në vendet në zhvillim do të jenë të kundërta me ato në vendet e zhvilluara. Për shembull, një masë mbrojtëse ndaj bujqësisë në një vend të varfër do të rezultonte në rritjen e çmimit të ushqimeve. Ajo do të sillte gjithashtu në një rritje të konsiderueshme të kërkesës për punë, për shkak të peshës së madhe të prodhimit bujqësor në ekonomi, pra edhe në një rritje të pagave, që gjithsesi zor se do të kompensonte rritjen e çmimit të ushqimeve.

Rritja e pagave, pra edhe e kërkesës në përgjithësi në ekonomi, do të sillte një rritje të çmimeve të mallrave të patregtueshme (mallrave të shërbimeve) dhe do të shkaktonte uljen e fitimeve në sektorin industrial. Mbrojtja e bujqësisë në këto kushte jo vetëm që nuk do të kishte kuptim nga pikëpamja ekonomike për shkak se efekti neto në mirëqënie do të ishte negativ, por do të ishte e vështirë nga pikëpamja politike, përderisa do të kundërshtojë nga përfaqësuesit e bizneseve në sektorin industrial, humbja relative (për biznes) e të cilëve do të ishte më e madhe sesa përfitimi relativ (për fermer) i fermerëve. Efekti do të jetë i kundërt në një vend të zhvilluar, ku mbështetja e bujqësisë, për shkak të përmasave të vogla të këtij sektori, ka më pak ndikim në paga, në çmimet e mallrave të patregtueshme dhe në fitimet e bizneseve industriale.

Shembull i një politike proteksioniste nga ana e vendeve të zhvilluara, është rasti i Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) të zbatuar nga BE. Kjo politikë ka konsistuar në tre elementë kryesorë: (i) garantimi i fermerëve nga Komuniteti për blerjen e produkteve bujqësore, në qoftë se çmimi arrinte një nivel të caktuar 'mbështetjeje'; (ii) përdorimi i një 'takse të ndryshueshme' (variable levy) ndaj importeve të produkteve bujqësore e barabartë me diferencën midis një çmimi kufi dhe çmimit më të ulët në tregun botëror, për të mos lejuar importimin e mallrave me çmim më të ulët sesa çmimi i përcaktuar si kufi; dhe (iii) kompensimi i eksportuesve evropianë për diferencën midis çmimit në tregjet e brendshme evropiane dhe çmimit mesatar në tregun botëror. Programi rezultoi të ishte shumë i shtrenjtë. Për shembull, për periudhën 1986-1990 kostoja vjetore e programit llogaritet 92 miliardë dollarë amerikanë. Për Japoninë dhe SHBA kostoja vjetore e mbështetjes së bujqësisë për të njëjtën periudhë llogaritet përkatësisht 35 miliardë dhe 24 miliardë dollarë amerikanë (Hoekman and Kostecki, 2001).

Në kuadrin e GATT-1947, bujqësia trajtohej në mënyrë specifike. Për produktet bujqësore lejohej kuotimi në prodhim apo eksport. Po kështu, lejohej edhe subvencionimi i eksportit të produkteve bujqësore të papërpunuara, deri në një masë të 'arsyeshme', që praktikisht ishte e papërcaktueshme. Me kalimin e kohës, në sektorin bujqësor u prezantuan lloje të ndryshme të pengesave tarifore, përjashtime nga angazhimet tarifore, pezullime të zbatimit të rregullave të GATT, etj.

Diskutimet në raundet e ndryshme të GATT lidhur me bujqësinë rezultuan joproductive, deri sa në Raundin e Uruguajt u arrit Marrëveshja mbi Bujqësinë. Në arritjen e Marrëveshjes ndikuan, përveç barrës shumë të rëndë të subvencioneve bujqësore, edhe disa zhvillime specifike gjatë viteve 1980-të, si presioni fiskal i ardhur nga dy goditjet e njëpasnjëshme të çmimeve të naftës, lufta e 'subvencioneve' midis EU dhe SHBA që e rëndonte edhe më shumë barrën e tyre, dhe një orientim më i theksuar pro tregut dhe konkurrencës në BE, në kushtet e thellimit të procesit integrues.

Marrëveshja mbi Bujqësinë ka katër pjesë kryesore, që merren përkatësisht me aksesin në treg, mbështetjen e brendshme, konkurrencën e eksportit, dhe masat sanitare dhe fitosanitare.

Lidhur me aksesin në treg, u ra dakord që vendet menjëherë të konvertonin NTB-të në tarifa<sup>27</sup>, të cilat brenda gjashtë viteve do të reduktoheshin me 36% në vendet e zhvilluara dhe 24% në vendet në zhvillim. Të gjitha mallrat bujqësore u përfshinë në kalendarin e angazhimeve tarifore<sup>28</sup>. Për shkak të niveleve të larta tarifore sipas angazhimeve në nivele që jo rrallë ndalonin çfardo lloj importi, u arrit marrëveshja për një minimum aksesit tregu përgjithësisht prej 5% në vitin 2000. Mjeti për të siguruar respektimin e këtij minimumi si rregull është kuota tarifore (tariff rate quota-TRQ), që nënkupton që tarifa për importet brenda një kuote është mjaft më e ulët sesa tarifa përtej kuotës. Në qoftë se importet kalojnë nivelet e synuara, mund të përdoren edhe masa siguruese.

Lidhur me subvencionimin e bujqësisë, në Marrëveshje parashikohet që masa agregate e mbështetjes (AMS)<sup>29</sup> së bujqësisë të reduktohet me 20% deri në vitin 2000, krahasuar me periudhën 1986-1988.

Vendeve në zhvillim u kërkohet të reduktojnë tarifat<sup>30</sup>, mbështetjen dhe subvencionimin e eksporteve deri në 2/3 e nivelit të periudhës 1986-1988, brenda vitit 2005. Për këto vende, vetëm mbështetja që kalon 10% të konsumit i nënshtrohet tarifimit dhe reduktimit të AMS. Lejohet subvencionimi i inputeve për fermerët me të ardhura të ulta, sikurse lejohet subvencionimi në përgjithësi i investimeve dhe subvencionimi i eksporteve për sa kohë që lidhen me marketingun e eksporteve dhe shpërndarjen dhe transportin e brendshëm.

Megjithë impulsset liberalizuese që vijnë nga Marrëveshja, shkalla e mbrojtjes së bujqësisë mbetet mjaft e lartë krahasuar me sektorët e tjerë dhe liberalizimi i pritur, mjaft modest. Presioni për vazhdimin e liberalizimit është i fortë. Zgjerimi i arritur dhe ai i synuar i BE që e bën të papërbalueshëm financiarisht CAP, është një nga faktorët që e kanë shtyrë BE drejt reformimit të Politikës së Përbashkët Bujqësore. Por nxitjet për liberalizim vijnë sidomos nga vendet në zhvillim, për të cilët pritet që përfitimet nga liberalizimi të jenë më të larta. Sipas vlerësimeve të Hertel et al (2000), një reduktim prej 40% të tarifave dhe subvencioneve në bujqësi pas raundit të Uruguajt do të sillte një rritje

<sup>27</sup> Ky proces u quajt tarifikim.

<sup>28</sup> Angazhimet tarifore (kufijtë tariforë) në shumë raste ishin shumë më të larta nga ekuivalentët tariforë të NTB të zbatuar në periudhën bazë 1986-1988. Për shembull, për EU ishin 60% më të larta, për SHBA 45% më të larta, për shumë vende në zhvillim 50% më të larta. Në këto kushte, tarifat e fillimit të shekullit XX nuk siguronin ndonjë mbrojtje më të lehtësuar sesa pengesat jotarifore në fillim të viteve 1990-të (Hoekman and Kostecki, 2001).

<sup>29</sup> Në AMS përfshihen shpenzimet për subvencionet, si dhe për politikat e mbështetjes së çmimeve. Përfshihen masat me efekte minimale, si dhe programet që nuk përmbajnë transferta direkte te fermerët por mbështesin bujqësinë në përgjithësi. Në rastin e BE, përfshihen pagesat kompensuese.

<sup>30</sup> Megjithëse nuk është përcaktuar ndonjë vit bazë për krahasim lidhur me tarifikimin.

në të ardhurat globale reale prej 600 miliardë dollarë amerikanë, pjesa më e madhe e të cilave do të shkonte në vendet në zhvillim.

Pas Raundit të Uruguajt, vendet e OECD janë orientuar intensivisht në përdorimin e kuotave tarifore. Në varësi me raportin midis kuotave të përcaktuara dhe importeve, liberalizimi i mëtejshëm do të kërkonte uljen e tarifave për sasi të mbi kuotat, apo për vetë kuotat, apo ndryshimin e kuotave.

Liberalizimi i bujqësisë, veçanërisht lëvizja drejt eliminimit të subvencioneve të eksportit, mund të rritë çmimin botëror të produkteve bujqësore, duke pasur kështu një efekt negativ në vendet importuese neto të ushqimeve. Në këtë rast nuk kërkohet doemos rritja e aftësive të çdo vendi për të prodhuar ushqime, në qoftë se ato nuk do të kishin avantazhe krahasuese në këtë drejtim. Sigurimi i mjeteve të nevojshme valutore, aksesit në kredi, ndihmat nga vendet në zhvillim, do të ishin disa nga rrugët e sugjeruara.

## **2.8 Raundi i Dohas dhe pengesat jotarifore**

Përpjekjet shumëpalëshe në kuadrin e OBT për liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë botërore kanë vazhduar edhe pas raundit të Uruguajt. Në nëntor të viti 2001 filloi një raund i bisedimesh në kuadrin e OBT, i quajtur Raundi i Dohas, i konsideruar ndryshe si Raundi i Zhvillimit për shkak të objektivave të gjera sociale dhe politike të liberalizimit tregtar lidhur me zhvillimin ekonomik, reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Në Doha, Ministrat e vendeve anëtare të BE ranë dakord për një “program të gjerë dhe të balancuar pune, që përfshinte një axhendë të zgjeruar negociatash si dhe vendime dhe aktivitete të tjera të rëndësishme, të nevojshme për të adresuar sfidat me të cilat ndeshet sistemi shumëpalësh i tregtisë”. Axhenda përmban çështje për negociata të menjëhershme, çështje për negociata të ardhshme, dhe çështje për shqyrtim të mëtejshëm në organizmat përkatëse të OBT. Në grupin e parë përfshihen bujqësia, shërbimet, mallrat industriale, rregullat e OBT lidhur me masat anti-dumping, subvencionet dhe masat kundërvepruese, zgjidhja e konflikteve, marrëveshjet rajonale dhe subvencionet e peshkimit.

Lidhur me bujqësinë, e cila ka një rëndësi të veçantë për shumicën e vendeve në zhvillim për shkak të peshës dërrmuese të sektorit në prodhimin e përgjithshëm bruto (PBB) dhe në punëzënie, kolonat kryesore të negociatave janë aksesit në treg, mbështetja e prodhimit vendas, dhe subvencionimi i eksporteve. Për sa i përket aksesit në treg, çështje që lidhen veçanërisht me objektivat e vendeve në zhvillim, janë vlerat shumë të larta tarifore për mallra të caktuara (tariff picks) dhe shkallëzi (eskalimi) tarifor, kutotat tarifore dhe administrimi i tyre, tarifatat specifike, etj. Megjithë reduktimin e rëndësishëm të tarifave për produktet bujqësore dhe megjithë nivelin shumë të ulët tarifor të zbatuar nga vendet e zhvilluara për produktet primare dhe lëndët e para bujqësore, tarifatat për produkte ushqimore të përpunuara drejt të cilave po përdoren interesat e vendeve në zhvillim, paraqiten ende mjaft të larta, duke arritur shpesh vlera maksimale.

Përpjekja e parë për t'u dhënë zgjidhje problemeve kryesore që preokuponin vendet anëtare në shtator të vitit 2003 në Mbledhjen Ministeriale në Kankun (Cancun), konsiderohet si një dështim. Schott (2004), duke analizuar shkaqet e dështimit të Kankunit, nënvizon tre prej tyre:

(i) *progresi i papërshtatshëm në ofertat negociuese në fushën e bujqësisë*. Ndërsa Shtetet e bashkuara ofruan propozime radikale liberalizimi në këtë sektor në verë të vitit 2002, BE vetëm në verën e vitit 2003 ra dakord për reformimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP). Në këto kushte, negociatorët nuk arritën të ofronin në kohë një 'kornizë' bisedimesh për sektorin e bujqësisë.

(ii) Përqëndrimi i vëmendjes nga ana e BE, pasuar edhe nga disa vende të tjera, si Japonia dhe Koreja, në "*çeshtjet e Singaporit*", veçanërisht në çeshtjen e investimeve, ndërkohë që vende të tjera, sidomos vendet në zhvillim, i konsideronin 'çeshtjet e Singaporit' si çeshtje të dekadës së ardhshme.

(iii) *Qëndrimi kundërshtues i shumë vendeve në zhvillim*, që kërkonin avancim të reformave në sektorin bujqësor nga ana e vendeve të zhvilluara. Si kundërpeshë ndaj këtij mosavancimi, shumë prej tyre e konsideronin të domosdoshme shtyrjen e bisedimeve pas afatit të përcaktuar të janarit 2005. Madje, një grup vendesh në zhvillim paraqitën kërkesa për kompensime monetare për vazhdimin e reformave tregtare, kërkesa që dilnin jashtë çdo kompetence të OBT.

Në përpjekjet e mëtejshme për të rigjallëruar Raundin e Dohas dhe për të adresuar më mirë shqetësimet e vendeve në zhvillim, në korrik të vitit 2004 u arrit një 'Marrëveshje Kornizë' për fokusimin e bisedimeve të mëtejshme kryesisht në mallrat bujqësore dhe ato industriale, për vendosjen e një afati për ofertat e bisedimeve lidhur me shërbimet dhe për fillimin e bisedimeve lidhur me lehtësimin e tregtisë. Në 'Marrëveshjen Kornizë' u rikonfirmua gjithashtu nevoja për progres serioz në negociata lidhur me çeshtjet e zhvillimit.

Mbledhja ministeriale e marsit 2005 (2-4 mars) në Kenia rikonfirmoi vullnetin politik dhe gatishmërinë për të shpënë përpara negociatat në të gjithë sektorët. Ndër të tjera, në Kenia u arrit në mendimin e përbashkët që:

*-Lidhur me shërbimet*, vendet anëtare angazhohen për të paraqitur një ofertë për akses në tregjet e tyre të shërbimeve deri në maj të vitit 2005.

*-Lidhur me aksesin në tregjet jobujqësore* (Non-Agriculture Market Access-NAMA), u kërkuar që vëmendja të përqëndrohet në zhvillimin e një formule për reduktimin pengesave tarifore, që shtrihet mbi të gjithë mallrat, realizon reduktim më të thellë në rastin e tarifave më të larta dhe që lejon fleksibilitet të mjaftueshëm për vendet në zhvillim. Një e veçantë tjetër është se kërkohet që reduktimi tarifor të jetë 'real', në normën e aplikuar të tarifave dhe jo në normën 'maksimale' të notifikuar në Gjenevë nga vendet anëtare. Diskutimi për këto çeshtje është parashikuar të behet në mbledhjen ministriale të Parisit që do të mbahet në maj 2005.

*-Lidhur me bujqësinë*, mbledhja e Kenias shënoi një progres real lidhur me aksesin në treg. U ra dakord që të punohej për arritjen e një marrëveshjeje të plotë në mbledhjen ministriale të Hong Kongut që do të mbahet në dhjetor 2005. Nga fundi i prillit 2005 vendet anëtare duhet të ofrojnë formulat e tyre për 'ekuivalentët vlerorë' (ad valorem equivalents), mbi bazën e të cilave do të bëhet e mundur të fillojë puna për përcaktimin e një formule për reduktimin tarifor.

Një faktor kryesor për suksesin e negociatave, është qëndrimi i BE. Në pjesën pasuese të punimit do të trajtojmë më gjerësisht qëndrimin e BE në negociatat në vazhdim dhe ato të pritshme.

## **2.9 Pengesat jotarifore, OBT dhe Shqipëria**

Që nga shtatori i vitit 2000 kur Shqipëria u bë anëtare e OBT, përpjekjet e saj për liberalizimin e rregjimit tregtar dhe hapjen ekonomike morën edhe formën e detyrimeve për plotësimin angazhimeve ndaj OBT, në përputhje me kalendarin e angazhimeve për reduktimet tarifore dhe në plotësim të kërkesave të Marrëveshjeve shumëpalëshe të OBT<sup>31</sup>.

Anëtarësimi në OBT përshpejtoi procesin e liberalizimit tarifor. Niveli më i lartë tarifor duke filluar nga viti 2001 ka qenë 15%, nga 20% që është angazhimi ndaj OBT. Është rritur ndjeshëm përqindja e linjave tarifore për të cilat zbatohet një nivel tarifor prej 0% (nga 17,2% në 2003, në 25,5% në 2004), ndërkohë që është ulur pesha e linjave tarifore që u nënshtrohen nivelit maksimal të tarifave (nga 27,5% në 2003, në 23,2% në 2004)<sup>32</sup>. Sidoqoftë, për një numër artikujsh nuk janë respektuar angazhimet ndaj OBT, me argumentin e mbrojtjes së prodhimit vendas. Shqipëria ka njoftuar<sup>33</sup> Sekretariatit e OBT për ndryshimin e kalendarit të realizimit të angazhimeve tarifore për një numër produktesh si birra, verë, letër muresh, etj., për një periudhë 3 vjeçare, por pa ndryshuar nivelin tarifor të synuar për vitin 2009<sup>34</sup>.

Në zbatim të detyrimeve që lindin nga anëtarësimi në OBT, në Shqipëri janë ndërmarrë dhe po ndërmerren një varg masash që lidhen me reformën legjislativë dhe institucionale, si në fushën e doganave; në atë të standardeve, çertifikimit, akreditimit e mbikëqyrjes së tregut; në fushën e masave të sigurisë (safeguard measures) dhe mbrojtjes së kushtëzuar (contingency protection), etj.

Krahas përfshirjes në procesin e liberalizimit shumëpalësh në kuadrin e OBT, Shqipëria është përfshirë edhe në proceset e integritimit rajonal, nëpërmjet Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë të lidhura me vendet e rajonit, në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë (MoU) të qershorit 2001, të nënshkruar nga vendet pjesëmarrëse në Paktin e Stabilitetit për Evropën Jugëlidore<sup>35</sup>.

Megjithatë efektet liberalizuese të MTL-ve, procesi i zbatimit të tyre është shoqëruar me mjaft vështirësi, shpesh të natyrës teknike apo administrative, siç mund të jenë ato që shoqërojnë zbatimin e rregullave të origjinës. Vështirësitë teknike dhe administrative kanë sjellë ndonjëherë zgjidhje që në vetvete përfaqësojnë pengesa serioze jotarifore për tregtinë midis vendeve të rajonit. I tillë është rasti i kryerjes së procedurave të zhdoganimit në këmbimet tregtare me Maqedoninë brenda kuotave të miratuara, vetëm nëpërmjet doganës së Qafë Thanës, duke rritur kostot e tregtimit për bizneset.

*Strategjia dhe Plani i Veprimit i Grupit të Punës për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë* për vitin 2004, ndër të tjera, mbështetur në MoU, parashikon ngritjen e një Sistemi Procedural (Procedure) për identifikimin, njoftimin (notifikimin) dhe eliminimin e pengesave jotarifore ndaj tregtisë. Ndër objektivat afatmesme, strategjia thekson nevojën e harmonizimit, sipas një kalendarit preciz, të rregullave dhe procedurave të vendeve të

<sup>31</sup>Shqipëria gjithashtu është përfshirë në procedurat e aderimit në Marrëveshjen mbi Prokurimin Publik, megjithësi aderimi në këtë marrëveshje nuk rrjedh si detyrim nga anëtarësimi në OBT.

<sup>32</sup> ACIT, Raporti i Tregtisë së Jashtme, 2003.

<sup>33</sup> Ndryshimet e njoftuara janë miratuar nga OBT.

<sup>34</sup> Sipas Paketës Fiskale të vitit 2005, birra do të vazhdojë të ketë një nivel tarifor prej 10%, megjithëse sipas kalendarit të angazhimeve do të duhej të ishte bërë 0% këtë vit; i njëjti ndryshim vihet re edhe për një sërë produktesh letre, si letër kartoni i paveshur, letër për mure, etj. (ACIT, Raporti i Tregtisë së Jashtme 2004).

<sup>35</sup> Një studim interesant lidhur me gjendjen e pengesave jotarifore në kuadrin e MTL-ve dhe masat e mundshme për reduktimin dhe eliminimin e këtyre pengesave, është ai i Messerlin and Mirdout (2004), i cili analizon konformitetin e 23 marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë në rajonin e Evropës Jugëlidore me MoU.

rajonit si me ato të BE (*acquis communautaire*), ashtu edhe midis tyre. Në veçanti, Strategjia thekson nevojën e harmonizimit të (i) ligjeve mbi konkurrencën; (ii) rregullave teknike, standardeve, sistemeve të vlerësimit të konformitetit dhe çertifikimit; dhe (iii) rregullave sanitare dhe fitosanitare. Lidhur me rregullat e origjinës, përpjekjet do të fokusohen për zbatimin në marrëdhëniet tregtare midis vendeve të rajonit, të sistemit pan-evropian të kumulimit të origjinës (Pakti i Stabilitetit, 2003).



### III. BARRIERAT JOTARIFORE, BASHKIMI EVROPIAN DHE SHQIPËRIA

Për Shqipërinë, tashmë të përfshirë në një proces intensiv integrimi në BE që përbën edhe partnerin kryesor tregtar të saj, është shumë e rëndësishme njohja dhe adoptimi i rregullave dhe instrumenteve institucionale të BE lidhur me adresimin e pengesave jotarifore ndaj tregtisë.

Kur i referohemi qëndrimit të BE ndaj barrierave jotarifore, duhet të mbajmë parasysh dy aspekte: (i) qëndrimin që mban BE ndaj barrierave jotarifore në lëvizjen e mallrave brenda territorit të BE, pra midis vendeve anëtare, dhe (ii) qëndrimin që mban BE ndaj barrierave jotarifore në lëvizjen e mallrave midis BE dhe pjesës tjetër të botës. Qëndrimi i BE ndaj barrierave jotarifore në lëvizjen e mallrave brenda territorit të saj, përderisa lidhet ngushtësisht me objektivin e krijimit të një tregu të brendshëm të njehësuar (internal market), është më ambicioz dhe përfaqëson një përfaqje më “agresive” ndaj këtyre barrierave. Artikujt korrespondues të Traktatit të Romës janë ndër artikujt që kanë qenë më shpesh subjekte gjykimi të Court of Justice (Gjykatës Evropiane).

Për Shqipërinë kanë rëndësi të dy aspektet. Ndërsa i dyti lidhet me statusin aktual të vendit, aspekti i parë lidhet me statusin e ardhshëm të pritshëm, por edhe me procesin e përfarimit ligjor dhe institucional me BE, në të cilin është përfshirë aktualisht vendi. Rëndësia e aspektit të parë rritet në përpjesëtim me intensifikimin e procesit të integrit. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me BE, që është pjesë integrale e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ende në proces negociimi, parashikon që lëvizja e lirë e mallrave midis Shqipërisë dhe BE të bazohet në parimet e ‘tregut të brendshëm’ të BE. Për këtë arsye mendojmë të qëndrojmë më shumë në këto parime, por pasi të kemi parë shkurtimisht pozicionin e BE-së lidhur me pengesat jotarifore në marrëdhëniet e saj tregtare me pjesën tjetër të botës.

#### 3.1 Bashkimi Evropian dhe pengesat jotarifore

Walkenhorst and Fliess (2003), vlerësojnë rëndësinë relative të llojeve të ndryshme të barrierave jotarifore ndaj eksporteve evropiane, bazuar në inventarin e ankesave të bizneseve<sup>36</sup>, i hartuar dhe përditësuar rregullisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tregtisë e Komisionit Evropian. Ankesat u referohen 46 vendeve të ndryshme; 39% e tyre u adresohen pengesave jotarifore në vendet me të ardhura të larta, ndërsa 61% pengesave jotarifore në vendet në zhvillim. Më shumë se 40% e ankesave lidhen me tregjet e Azisë Lindore dhe të Pacifikut, pasuar nga tregjet e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore (23%), dhe të Amerikës së Veriut (14%). Nga pikëpamja sektoriale, 43% e ankesave u takojnë makinerive, prodhimit të ushqimit, dhe kimikateve (përkatësisht 19%, 14% dhe 10%). Nga pikëpamja e llojeve të pengesave jotarifore, 17% e të gjithë ankesave u adresohen pengesave sasiore dhe pengesave që lidhen me kontrollin e çmimeve<sup>37</sup>. Çertifikimi dhe


<sup>36</sup> Inventari i vitit 2000 regjistron një total prej 1708 ankesash të bizneseve për masat jotarifore. Të dhënat lidhur me inventarin e ankesave gjenden në European Commission’s Market Access Database, që mund të adresohet nëpërmjet internetit në faqen <http://mkacdb.eu.int>.

<sup>37</sup> Që së bashku formojnë grupin e ‘core NTB-masa jotarifore thelbëzore’.

standardized janë pengesat më të adresuara nga ankesat e biznesmenëve; vetëm çertifikimi arrin në 15% të ankesave, duke u renditur e para ndër të gjitha pengesat jotarifore.

Figura 1 paraqet rëndësinë relative të pengesave të ndryshme jo tarifore, sipas sektorëve kryesorë. Për të gjithë sektorët vërehet mbizotërimi i standardeve dhe çertifikimit. Peshë të rëndësishme kanë gjithashtu ndërhyrjet qeveritare, kufizimet sasiore dhe ato lidhur me çmimin, etj. Tabela A3 në Aneks paraqet rëndësinë relative të pengesave tarifore sipas llojit të pengesave dhe sektorëve.

Figura 1: Rëndësia relative e tipeve të ndryshme të NTB sipas sektorëve<sup>38</sup>



Lidhur me qëndrimin që po mban BE ndaj pengesave jotarifore për importet, në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se, *së pari*, në kushtet e zgjerimit të BE me vende të reja anëtare dhe një numër vendesh të tjera që aspirojnë të anëtarësohen, është rritur shumë kostoja e politikave subvencionuese, veçanërisht në kuadrin e Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) dhe BE, duke filluar nga viti 2003, po ecën shpejt në drejtim të liberalizimit të pengesave jotarifore të kësaj natyre; dhe, *së dyti*, ka ardhur duke u rritur roli i BE si faktor nxitës në bisedimet shumëpalëshe për liberalizimin e tregtisë.

Veçanërisht pas takimit ministerial të Kankunit, BE ka shtuar përpjekjet e saj për intensifikimin e bisedimeve për adresimin e çështjeve kryesore të shtruara për diskutim në Axhendën e Dohas, veçanërisht për çështje të tilla, si aksesin në treg, mbështetja e prodhimit vendas dhe mbështetja e eksportit, që konsiderohen si ‘tri shtyllat’ e axhendës së Dohas (Chantal, with Hans and Brockmeier, 2004).

BE ka dhënë një kontribut të veçantë në arritjen e ‘Marrëveshjes Kuadër’ të korrikut’ 2004, e cila do të shërbejë si platformë për bisedimet e mëtejshme dhe për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare brenda vitit 2006.

Lidhur me *bujqësinë* veçanërisht lidhur me subvencionet në këtë sektor, ‘Marrëveshja Kuadër’, *nuk kapërcen reformimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE*<sup>39</sup>, të realizuar kohët e fundit. Konkretisht, për sektorin bujqësor synohet:

<sup>38</sup> Marrë nga Walkenhorst and Fliess (2003).

- ulje në mënyrë të ndjeshme e mbështetjeje më deformuese të tregtisë;
- ulje e mbrojtjes tarifore në bujqësi, duke realizuar ulje më të madhe për tarifën më të larta. Në kushtet e debateve lidhur me formulën e reduktimit tarifor, BE mban një qëndrim fleksibël, duke u paraqitur e gatshme për diskutimin e të gjitha qëndrimeve të vendeve të veçanta për formulën që duhet zbatuar<sup>40</sup>.
- brenda vitit të parë të periudhës së zbatimit duhet të realizohet ulja me 20% e pagesave subvencionuese; një ulje e tillë është më e madhe sesa ulja e realizuar sipas Marrëveshjes së Uruguajt për gjashtë vjet;
- subvencionet më të larta do t'i nënshtrohen uljes më të madhe;
- mbështetja e 'boksit blu'<sup>41</sup> nuk mund të kalojë 5% të vlerës së produktit bujqësor, por nuk parashikohet ulje e mëtejshme;
- 'boksi i gjelbër'<sup>42</sup> mbetet i paprekur;
- niveli i 'de minimis'<sup>43</sup> do të ulet.

Lidhur me *praktikat e deformimit të eksporteve*, 'Marrëveshja Kuadër' plotëson kërkesën e BE për trajtim të barabartë të të gjitha formave të praktikave të eksportit që deformojnë tregtinë. BE ka rënë dakord të ulë gradualisht deri në eliminim subvencionet ndaj eksporteve duke kërkuar një "paralelizëm të plotë", pra me kusht që edhe partnerët tregtarë të saj të eliminojnë programet e mbështetjes së eksporteve. Mbi këtë bazë, BE ofron që:

- subvencionet e BE për eksportet, kreditë për eksportet, garancitë për kreditë dhe programet e sigurimit me periudha ripagese më shumë se 180 ditë, të eliminohen në datën që do të përcaktohet në marrëveshje;

<sup>39</sup> Elementët kryesorë të reformimit të Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) të BE janë: (i) kalohet në një pagesë të njëjtë për fermerët, pavarësisht nga prodhimi; pagesa dyfishe mund të vazhdojnë të mbahen vetëm për të shmangur braktisjen e prodhimit; (ii) pagesat do të lidhen me standardet për mjedisin, sigurinë ushqimore, shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, si dhe me kërkesat për mbajtjen e fermës në kushte të mira bujqësore; (iii) forcimi i mbështetjes së zhvillimit rural; (iv) reduktimi i pagesave direkte për fermat e mëdha; (v) rishikimi i politikës tregtare të CAP.

<sup>40</sup> Dy nga formulat në diskutim kanë qenë (i) *'formula zviceriane'* (Swiss formula), sipas së cilës vendet duhet të realizojnë uljen më të madhe në tarifën më të larta, duke ngushtuar hendekun midis tarifave të larta dhe tarifave të ulëta; dhe (ii) *'formula e përzjerë'* (blended formula), sipas së cilës reduktimi i tarifave mbështetet në përzjerjen e tre kriterëve: (a) qëndrimin të Raundit të Uruguajt, sipas të cilit kërkohet një reduktim në nivelin mesatar të tarifave në një përqindje të caktuar (të negociuar) përgjatë një periudhe kohe të dhënë, duke lejuar hapësira për ulje më të vogla tarifore për produkte të ndjeshme ndaj importit; (b) formula zviceriane; dhe (c) ulja e tarifës në nivelin zero. Sipas peshave që u jepen kriterëve të ndryshme, janë propozuar formula të ndryshme 'të përzjera'. 'Formula e përzjerë' e propozuar nga SHBA, e cila konsiderohet shumë kufizuese nga ana e BE dhe një numër vendesh të tjera, përfshirë vende në zhvillim, parashikon që kriteri i Raundit të Uruguajt të mund të zbatohet për jo më shumë se 3% të linjave tarifore të produkteve bujqësore. (Nielsen, with Jensen and Brockmeier, 2004).

<sup>41</sup> Në 'boksit blu' përfshihen politika subvencionuese që marrin formën e pagesave për kufizimin e prodhimit, duke imponuar kuota prodhimi apo duke u kërkuar fermerëve të lenë pa kultivuar një pjesë të tokës së punueshme (WTO, 2003).

<sup>42</sup> Në 'boksit e gjelbër' përfshihen subvencionime të pakundërveprueshme, të cilat nuk kanë efekte deformuese në treg, ose efektet janë minimale. Për t'u kualifikuar në 'boksit e gjelbër', subvencionet (i) duhet të financohen nga qeveria (duke mos marrë formën e çmimeve më të larta për konsumatorët), (ii) nuk duhet të marrin formën e mbështetjes së çmimeve; (iii) duhet të marrin formën e mbështetjes së të ardhurave të fermerëve; dhe (iv) nuk duhet të lidhen me nivelet korrente të çmimeve apo të prodhimit (WTO, 2003).

<sup>43</sup> Është fjala në subvencionime për firma të veçanta (kryesisht për ndërmarrje të vogla dhe të mesme), që aktualisht në rastin e BE nuk mund të kalojnë nivelin 100.000 Euro dhe zbatohen për një periudhë deri në tre vjeçare.

- kreditë për eksportet, garancitë për kreditë dhe programet e sigurimit me periudha ripagese më pak se 180 ditë, t'u nënshtrohen një disipline të shtrënguar lidhur me elementët subvencionues dhe elementët e tjerë deformues të tregtisë;
- ndihma ushqimorë për njerëzit në nevojë të vazhdojë, por duke mos lejuar abuzimet me të për qëllime tregtare.

Gjithashtu, BE ka treguar fleksibilitet për të ashtuquajturat '*Çeshtje të Singaporit*'<sup>44</sup>, të cilat faktikisht janë hequr nga axhenda e bisedimeve të tanishme në kuadrin e Raundit të Dohas, por do të vazhdojnë të mbeten në axhendën e OBT-së.

*'Tregu i brendshëm' dhe lëvizja e lirë e mallrave*

Lëvizja e lirë e mallrave në kuadrin e 'tregut të brendshëm' të BE mbështetet në artikujt 28, 29 dhe 30 të Traktatit Themelues të Bashkimit Evropian, të paraqitur në boksën e mëposhtëm.

*Artikulli 28 (ish Neni 30)*

Kufizimet sasiore mbi importet dhe të gjitha masat që kanë efekt ekuivalent me to, ndalohen midis vendeve anëtare.

*Artikulli 29 (ish Neni 34)*

Kufizimet sasiore mbi eksportet dhe të gjitha masat që kanë efekt ekuivalent me to, ndalohen midis vendeve anëtare.

*Artikulli 30 (ish Neni 36)*

Masat e parashikuara në Nenet 28 dhe 29 nuk kanë fuqi vepruese mbi ndalimet apo kufizimet e importit, eksportit, apo tranzitit të mallrave, të cilat janë të justifikuar nga pikëpamja e moralit publik, politikave publike, apo sigurimit publik; nga pikëpamja e mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëze, kafshëve, apo bimëve; nga pikëpamja e mbrojtjes së thesareve kombëtare që përmbajnë vlera artistike, historike, apo arkeologjike; ose nga pikëpamja e mbrojtjes së pronësisë industriale dhe komerciale. Të tilla ndalime apo kufizime, megjithatë, nuk mund të përbëjnë një mjet të diskriminimit arbitrar apo të kufizimit të maskuar të tregtisë midis vendeve anëtare.

*Marrë nga: Treaty Establishing the European Community, Chapter 2: Prohibition of Quantitative Restrictions Between Member States.*

Përcaktimi i përdorur në Artikujt 28 dhe 29 të Traktatit 'kufizime sasiore ... dhe masa që kanë efekt ekuivalent me to', u referohet pikërisht *pengesave jotarifore*. Sipas Direktivës 70/50 të Komunitetit Evropian<sup>45</sup>. "Të gjitha rregullat tregtare të nxjerra nga vendet anëtare, të cilat mund të pengojnë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, aktualisht apo potencialisht, tregtinë brenda Komunitetit, duhet të konsiderohen si masa që kanë efekt ekuivalent me kufizimet sasiore". Këtyj përkufizimi vazhdon t'i referohet edhe Court of Justice, me disa ndryshime të vogla. Për shembull, nuk përdoret më termi 'rregulla tregtare', dhe në vend të 'tregtisë brenda-komunitare', flitet për 'tregti midis shteteve anëtare'.

<sup>44</sup> Çeshtje që lidhen me investimet, konkurrencën, transparencën në prokurimet publike dhe lehtësimin e tregtisë.

<sup>45</sup> Kjo direktivë nuk ka më fuqi ligjore, përderisa është zbatuar vetëm gjatë periudhës së tranzicionit.

Philipson (2001), bazuar në rastet gjyqësore në Court of Justice, analizon masa të ndryshme shtetërore<sup>46</sup> me efekt ekuivalent me kufizimet sasiore. Përmendja e disa prej tyre është me interes, përveç të tjerash, edhe për të parë se sa i 'pasur' është koncepti i pengesave jotarifore dhe sesi pasurohet ai më tej, kur është fjala për bashkësi vendesh të integruara ekonomikisht.

Ndër masat e ndryshme që, mështetur në përvojën gjyqësore, konsiderohet të kenë efekt ekuivalent me kufizimet sasiore ndaj importit, përmenden:

- (i) Licensat dhe lejët e importit, përfshirë licensat automatike;
- (ii) Detyrimin për të nxjerrë çertifikata, përfshirë rastet e çertifikatave të origjinës, të autencitetit, çertifikatat sanitare e fitosanitare, etj.
- (iii) Inspektime dhe kontrole, përfshirë ato veterinare, sanitare, fitosanitare, si dhe kontrole doganore të importeve apo eksporteve.
- (iv) Gjoha dhe sanksione në rastet kur, *së pari*, lidhen me kufizime të importit, kur vetë kufizimet bien ndesh Artikullin 28 të Traktatit dhe, *së dyti*, janë më të larta për importet, krahasuar me produktet vendase.
- (v) Kushtëzime për kreditim apo pagesa, të diferencuara nga ato që përdoren për prodhimin vendas.
- (vi) Detyrimi për të emëruar një përfaqësues në territorin e shtetit anëtar importues.
- (vii) Detyrimi për të pasur mundësi depozitimi në shtetin anëtar importues.
- (viii) Rregullimet nacionale dhe kontrollet e çmimeve:
  - (a) çmimet maksimale, edhe kur janë njësoj të zbatuara ndaj produkteve vendase dhe atyre të importit, në rastet kur bëjnë të pamundur apo vështirësojnë shitjen e mallit të importuar;
  - (b) ngrirjet e çmimeve (kërkesa që rritja e çmimit të një malli të njoftohet tek autoritetet brenda një periudhe kohe të caktuar përpara se të zbatohet), edhe kur zbatohet njëllor për mallra të importit dhe ato vendase, por ngrirja është në nivele të tilla që e bën shitjen e mallrave të importuara më të vështirë sesa shitjen e mallrave vendase;
  - (c) çmimet minimale, edhe kur zbatohen njëllor për mallrat e importit dhe mallrat vendase, por që mund të pengojnë importet duke penguar konkurrencën;
  - (d) përcaktimi i kufijve maksimalë të fitimeve, kur ai është i fiksuar në një masë te vetme si për produktet vendase, dhe nuk mban parasysh kostot e importimit për importuesit.
- (ix) Rimbursimi i medikamenteve mjekësore, në rrethana të caktuara.
- (x) Detyrimi për të bërë deklaratë origjine (megjithëse kjo masë mund të konsiderohet e justifikuar në rastin kur paketimi dhe etiketimi i produktit janë dezinformuese për konsumatorin).
- (xi) Nxitjet për të blerë produktet vendase.
- (xii) Detyrimi për të përdorur gjuhën kombëtare në statet përpara shitjes së produktit tek konsumatori përfundimtar.
- (xiii) Rezervime abuzive për përdorimin e emrave të produkteve, që nuk janë tregues të origjinës apo burimit.

---

<sup>46</sup> Cilësimi 'shtetërore' nënkupton jo vetëm masa të ndërmarra nga qeveria qendrore, por edhe nga qeveritë lokale apo rajonale, institucionet publike, përfshirë institucione ligjvënse, administrative, gjyqësore madje edhe institucione gjysmë-publike (siç mund të jetë një organizëm profesional, të cilit i janë akorduar me ligj fuqi rregullatore apo disiplinuese).

- (xiv) Kufizime abuzive në përdorimin e termave të përgjithshëm.
- (xv) Kufizimi i importeve paralele (importi i të njëjtit produkt nga tregtarë të tjerë).
- (xvi) Rregullime teknike që përmbajnë kërkesa lidhur me prezantimin e produktit (peshë, kompozimi i peshës, etiketimi, forma, masa, paketimi), në rastet kur zbatueshmëria e tyre për produktet vendase nuk është e qartë.
- (xvii) Ndhurma shtetërore, kur ajo deformon apo kërcënon të deformat konkurrencën, duke favorizuar subjekte të caktuara apo prodhimin e produkteve të caktuara në masë të tillë, sa ndikon në tregtinë midis vendeve anëtare.
- (xviii) Diskriminimi në kontratat e ofertës publike, që lidhet me: (a) ndalimin e plotë apo të pjesshëm të përdorimit të një produkti të importuar; (b) kërkesën për përdorim të plotë apo të pjesshëm të produkteve vendase; (c) vështirësimin e importimit të produkteve.
- (xix) Sistemet e licensimit, në rastet kur vetëm zotëruesit e një license prodhimi apo shitjeje me shumicë lejohet të importojnë një produkt të caktuar.

Ndër masat e ndryshme që, mbështetur në përvojën gjyqësore konsiderohet të kenë efekt ekuivalent me kufizimet sasiore ndaj *eksportit*, përmenden masat nacionale që rregullojnë vetëm prodhimin që synon tregjet e eksportit (Philipson, 2001).

Të dobishme mund të ishin edhe disa sqarime lidhur me ndalimet apo kufizimet përjashtimore që parashikon Neni 30 i Traktatit, bazuar në rastet e gjykuara në Court of Justice. Një vend anëtar mund të zbatojë një masë përjashtimore bazuar nën Nenin 30, vetëm në qoftë se ajo nuk përbën një mjet diskriminimi arbitrar ose një kufizim të maskuar të tregtisë midis vendeve anëtare.

Rastet përjashtimore të ndalimit apo kufizimit të lejuar të importit dhe eksportit, të parashikara në Nenin 30, lidhen me moralin publik; sigurimin publik; mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve dhe bimëve; mbrojtjen e thesareve kombëtare që përmbajnë vlera artistike, historike dhe arkeologjike; dhe mbrojtjen e pronësisë industriale dhe komerciale.

- (i) *Lidhur me moralin publik*, ndalimi i importit të produkteve të caktuara konsiderohet i justifikuar nga pikëpamja e Nenit 30, vetëm në qoftë se ndalimi shtrihet edhe në marketimin<sup>47</sup> e këtyre produkteve, qoftë kur ata janë prodhuar në vend.
- (ii) *Arësyeja e politikës publike* ka qenë pranuar në Gjykatën Evropiane vetëm në një rast, në rastin e kufizimit të importit dhe eksportit të monedhave të koleksionuara të floririt, me argumentin se tradicionalisht ka qenë konsideruar si aspekt i interesave themelore të shtetit.
- (iii) *Lidhur me sigurimin publik*, shembuj të konsiderimit të rasteve përjashtimore lidhen me ‘sigurimin e kapaciteteve prodhuese të rafinerive të naftës, për të përballuar kërkesën në raste krizash’, dhe ‘sigurinë e rrugëve’ (Philipson, 2001).
- (iv) *Arësyt e ruajtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve dhe bimëve*, Court of Justice e konsideron si arsye të parë për raste përjashtimore. Tërhiqet vëmendja që: (i) nuk do të kishte arsye për masa përjashtimore, kur shëndeti dhe jeta e njerëzve mund të mbrohen po aq mirë nga masa që nuk kufizojnë tregtinë midis vendeve anëtare; (ii) vendet importuese duhet të njohin testimet

<sup>47</sup> Në kuptimin e ‘tregtimit brenda vendit’.

- dhe kontrollet e kryera në vendin anëtar eksportues, që japin të njëjtat garanci. Vendet anëtare nuk duhet të dublojnë kontrollet në mënyrë sistematike, por ato mund të kryejnë kontrole apo teste në rastet kur, sipas të dhënave të inspektimit në vendet eksportuese, ka pasur prova për ndonjë sëmundje; (iii) në raste të pasigurisë që buron nga gjendja prezente e kërkimit shkencor, konsumatorët mund të mbrohen nga risku lidhur me sëmundje të caktuara që mund të shoqërojnë produktet apo shërbime, nëpërmjet zbatimit të ‘parimit të përkujdesjes’.
- (v) *Lidhur me mbrojtjen e thesareve kombëtare që përmbajnë vlera artistike, historike dhe arkeologjike, nuk ka pasur asnjë rast të gjykuar në Gjykatën Evropiane. Sidoqoftë, në një nga rastet është sugjeruar se kjo arsye mund të justifikojë një kufizim sasior. Mbi këtë bazë, janë adoptuar dy masa të rëndësishme kufizuese. Së pari, Rregullorja 39<sup>1</sup>/9<sup>2</sup> mbi eksportin e artikujve kulturorë, bën të detyrueshme kontrollet në kufijtë e vendeve eksportuese për eksportin e artikujve të mbrojtur në vende joanëtare. Së dyti, Direktiva 93/7<sup>80</sup> lidhur me kthimin e objekteve kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga një vend anëtar, u jep të drejtë vendeve anëtare për të përcaktuar thesaret kombëtare, si dhe për kooperim midis autoriteteve nacionale për të siguruar kthimin e objekteve të larguara.*
- (vi) *Lidhur me mbrojtjen e pronësisë industriale dhe komerciale, nënvizohen dy parime që mund të dalin nga rastet e gjykuara: (i) traktati nuk ndikon në ekzistencën e të drejtave të pronësisë industriale të dhëna mbi bazën e legjislacionit të vendeve anëtare (ky parim, sidoqoftë, nuk zbatohet në rastet kur ka elementë të diskriminimit në rregullat kombëtare); dhe (ii) e drejta e pronësisë industriale shuhet kur produkti shpërndahet në mënyrë të ligjshme në tregun e një vendi anëtar nga zotërues i kësaj të drejte, me pëlqimin e tij. Për këtë arsye, zotërues i të drejtës nuk mund të kundërshtojë importimin e këtij produkti në tregun e vendit anëtar, ku ai është marketuar për herë të parë.*

### **3.2 Procesi i integritimit evropian dhe pengesat jotarifore në Shqipëri**

Zbatimi i parimit të lëvizjes së lirë të mallrave në rastin e BE nënkupton që vendet anëtare *nuk mund të ruajnë apo të vendosin* pengesa në fushat, të cilat nuk kanë qenë subjekte të harmonizimit komunitar, përveçse në rrethana të veçanta. Mosruajtja apo mosvendosja e pengesave, nënkupton zbatimin e parimit të *njohjes reciproke*. Sipas këtij parimi, në çdo sektor që nuk ka qenë subjekt i masave harmonizuese në nivel komunitar ose i cili mbulohet vetëm nga masa minimale apo jo të detyrueshme (opsionale) harmonizuese, çdo vend anëtar është i detyruar të pranojë në territorin e tij produkte që janë prodhuar dhe marketuar *në mënyrë ligjore* në një vend tjetër anëtar. Kjo nënkupton që prodhimi dhe marketimi i produkteve të tregtuara u nënshtrohet ligjeve dhe rregullave në thelb të njëjta, apo të përafuara. Prania e ligjeve dhe rregullave të njëjta apo të përafuara dhe e institucioneve të afta për zbatimin e tyre, qëndron në themel të parimit të *besimit reciprok*. Parimi i besimit reciprok bën të mundur parimin e njohjes reciproke, dhe parimi i njohjes reciproke bën të mundur parimin e *lëvizjes së lirë të mallrave*.

Për një vend si Shqipëria, që aspiron të integrohet në BE, kjo do të thotë që për ta bërë parimin e *lëvizjes së lirë të mallrave të zbatueshëm*, pra edhe për të rritur mundësitë e

eksportimit të mallrave shqiptare në vendet anëtare të BE, në marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe BE duhet të zbatohet parimi i *njohjes reciproke*. Për ta bërë këtë të fundit të zbatueshëm, midis Shqipërisë dhe vendeve të BE duhet të ndërtohet *besimi reciprok*. Që besimi reciprok të arrihet dhe të funksionojë, kusht i domosdoshëm është *përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit dhe i bazës rregullatore me atë të BE*, dhe ndërtimi i institucioneve të afta për zbatimin e tyre” (Mançellari, 2004).

Në veçanti, është e nevojshme që në Shqipëri të përshtaten dhe zbatohen kërkesat evropiane për rregullat teknike, standardet dhe rregullat sanitare dhe fitosanitare, si dhe kërkesat evropiane për kontrollin cilësor, testimin, çertifikimin dhe akreditimin, për kontrollin e tregut, për rregullat e origjinës, etj. Ngritja e institucioneve përkatëse dhe plotësimi e përshtatja e bazës ligjore e rregullatore në fushat e mësipërme, është një masë e domosdoshme për mbrojtjen e konsumatorit, për ruajtjen e shëndetit të njerëze, kafshëve dhe bimëve; për ruajtjen e mjedisit dhe sigurinë kombëtare, etj. Por, ato janë edhe një instrument i rëndësishëm për rritjen e aftësisë konkurrese dhe nxitjen e eksporteve shqiptare. Sidoqoftë, edhe pse të nevojshme për arritjen e synimeve të mësipërme, masat teknike mund të funksionojnë efektivisht si pengesa ndaj tregtisë kur janë të paqarta, jo transparente, dhe kur zbatimi i tyre kalon përmes procedurave burokratike të stërzgjatura dhe të kushtueshme për biznesin.

Natyrisht, *lëvizja e lirë e mallrave* kërkon edhe liberalizimin e plotë të rregjimit tregtar me BE, që do të thotë uljen dhe eliminimin gradual të tarifave mbi importin dhe njëkohësisht reduktimin dhe eliminimin e pengesave jotarifore ndaj tregtisë. Të gjitha këto ndryshime dhe përshtatje janë parashikuar në Marrëveshjen për Stabilizim-Asocim, që është ende në process negocimi.

#### *Marrëveshja e Stabilizim Asocimit dhe pengesat jotarifore*

Një impuls i fuqishëm në zbatimin e rregullave të ‘tregut të brendshëm’ dhe në ngritjen e institucioneve përkatëse, pritet nga Marrëveshja e Stabilizimit-Asocim (MSA). Efekti i Marrëveshjes po ndihet edhe gjatë procesit të negocimit të saj, por ai pritet të jetë shumë më i rëndësishëm pas nënshkrimit. Sipas Nenit 16.1 të MSA, ‘Komuniteti dhe Shqipëria do të krijojnë një zonë të tregtisë së lirë përgjatë një periudhe që zgjat maksimumi 10 vjet nga dita e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, në pajtim me nenet e kësaj Marrëveshjeje dhe në konformitet me ato të GATT 1994 dhe WTO...’.

Nenet 18.2 dhe 19.4 përcaktojnë se ‘kufizimet sasiore mbi importet (përkatësisht në Komunitet dhe në Shqipëri) dhe masat që kanë efekt ekuivalent me to, duhet të eliminohen që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje (lidhur me produktet e origjinuara përkatësisht në Shqipëri dhe në Komunitet)’. Neni 19, pikat 1, 2, dhe 3 përcaktojnë detyrimin e Shqipërisë për të eliminuar dhe reduktuar gradualisht<sup>48</sup> tarifat mbi mallrat e importit. Neni 20 përcakton që Komuniteti dhe Shqipëria do të eliminojnë çdo pagesë në tregtinë midis tyre, që ka efekt ekuivalent me tarifën mbi importet me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Neni 21 dhe neni 22 parashikojnë eliminimin e tarifave mbi eksportet, dhe pagesave të tjera apo kufizimeve sasiore dhe masave që kanë efekt ekuivalent me to, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

---

<sup>48</sup> Reduktimi dhe eliminimi gradual është parashikuar për një numër mallrash të konsideruara të ndjeshme apo me ndjeshmëri të vacantë, me një shtirje kohore deri në janar 2009.



Neni 33 detyron palët që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, nuk mund të prezantojnë asnjë masë e re tarifore mbi importet dhe eksportet, dhe asnjë pagesë tjetër apo kufizim sasior që ka efekt ekuivalent me to.

Në Marrëveshje u kushtohet rëndësi e veçantë pengesave tarifore dhe masave jotarifore në sektorin e bujqësisë dhe të peshkimit, si dhe rregullimit të dumpingut dhe subvencioneve të kundërveprueshme dhe masave përkatëse kundërvepruese; skemave të ndihmës ekonomike dhe mbrojtjes së konkurrencës; pronësisë komerciale, industriale dhe intelektuale; prokurimit publik; rregullave teknike dhe standardeve, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit; mbrojtjes së konsumatorit; etj.

### ***Gjendja e pengesave jotarifore në Shqipëri***

Tschäni and Wiedmer (2001), analizojnë gjendjen e pengesave tarifore në një numër vendesh të Paktit të Stabilitetit për Evropën Jugë-Lindore, përfshirë Shqipërinë. Në rastin e Shqipërisë, autorët u kushtojnë më shumë vëmendje (i) licensave të importit dhe eksportit; (ii) vlerësimit doganor dhe funksionimit të doganave, (iii) pengesave teknike ndaj tregtisë (TBT) dhe masave sanitare dhe fitosanitare (SPS), dhe (iv) hendekut midis legjislacionit përkatës, dhe rregullave e instrumenteve që bëjnë të mundur zbatimin e tyre.

Në të gjitha drejtimet e mësipërme ka ndryshime pozitive krahasuar me kohën të cilës i referohen autorët (viti 2001), por ende shumë probleme janë prezente. Më poshtë do të përpiqemi të evidentojmë disa nga ndryshimet dhe problemet në disa nga drejtimet e mësipërme.

### ***Licensimi i importeve dhe eksporteve***

Në kuadrin e përpjekjeve për anëtarësim në OBT, Shqipëria ka aderuar në Marrëveshjen e OBT për Procedurat e Licensimit, që në vitin 1999. Por, megjithëse Vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave (6 tetor 1999) riprodhonte fjalë për fjalë Marrëveshjen e OBT, shtrirja e licensimit dhe procedurat përkatëse në disa aspekte bien ndesh me frymën e Marrëveshjes dhe përfaqësojnë në vetvete pengesa ndaj biznesit, e veçanërisht ndaj importit.

Tschäni and Wiedmer (2001) tërheqin vëmendjen për: (i) nevojën, në mjaft raste, për zëvendësimin e kërkesës për ‘licensë’ me kërkesën për ‘lejë’ importi për produkte të caktuara, të cilat u nënshtrohen kërkesave teknike të caktuara dhe zbatimi i këtyre kërkesave mund të kërkojë njohuri profesionale të caktuara nga ana e importuesit; (ii) shkurtimin e listës së produkteve për të cilat kërkohet licensë (lejë) importi, duke përmendur në mënyrë specifike vezët, leshin dhe lëkurët e papërpunuara; dhe (iii) thjeshtimin e procedurave për marrjen e licensave. Edhe në studimin e Fias-it (2003) shtrirja dhe procedurat e licensimit konsiderohen një pengesë e rëndësishme për biznesin.

Për periudhën pasuese janë shënuar një sërë ndryshimesh pozitive në drejtim të licensimit.

- (i) Mbi bazën e sugjerimeve të Tschäni and Wiedmer (2001), për një numër sektorësh e produkteve, është kaluar nga përdorimi i ‘licensave’ në përdorimin e ‘leveve’ për veprimtarinë e importit.

- (ii) Mbi bazën e sugjerimeve të Fias (2003)<sup>49</sup>, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 398, datë 13.6.2003, janë eliminuar licensat për ‘industrinë jo ushqimore’<sup>50</sup> dhe është shkurtuar lista e licensave (lejeve) të nevojshme për të ushtruar biznese të caktuara apo për veprimtari import-eksporti.
- (iii) Janë bërë përpjekje për një informim më të mirë të biznesit lidhur me kërkesat dhe procedurat e licensimit. Mund të përmendim këtu edhe Guidën për Procedurat e Licensimit në Shqipëri, të botuar në vitin 2004 nga IDRA, me mbështetje të USAID.

Megjithatë,

- (a) Lista e licensave, lejeve, autorizimeve dhe çertifikatave paraqitet ende shumë e gjatë; po ashtu edhe lista e institucioneve që i lëshojnë ato: më shumë se 120 lloje licensash, lejesh, autorizimsh dhe çertifikatash, të lëshuara nga rreth 30 institucione.
- (b) Procesi i rishikimit të rregullave teknike të detyrueshme dhe kërkesave sanitare dhe fitosanitare, si dhe të procedurave të testimit të konformitetit dhe kontrollit në kuadrin e përafrimit ligjor me BE, do të kërkonte edhe rishikimin e shtrirjes, të procedurave të lëshimit, dhe të përcaktimit të qëllimit të licensave dhe lejeve përkatëse.
- (c) Megjithë hapat pozitivë, ende institucionet shtetërore janë ‘të kursyera’ në publikimin e informacionit të nevojshëm. Në gjendje ‘varfërie’ duket se janë site-t e këtyre institucioneve në internet.
- (d) Në sektorë të caktuar (si trojet, shërbimet financiare, transporti, etj.) ende ka dallime lidhur me nacionalitetin për lëshimin e një një license apo autorizimi. Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit parashikon shuarjen graduale të këtyre dallimeve.
- (e) Ende perceptimi i biznesit është se për t’u pajisur me një lejë importi (eksporti), duhet të kalosh përmes procedurash të lodhshme burokratike.

Hemstead (2004), në studimin e kryer në vitin 2004 në kuadrin e Programit CARDS lidhur me pengesat jotarifore në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, lidhur me licensat e importit nënvizojnë se në Shqipëri ato ‘...kërkohen për çdo ngarkesë mallrash mbi të cilat zbatohet licensimi’ dhe se ‘...vërehet mungesë transparence në vendimet e marra dhe ka akuza për arbitraritete’.

#### *Procedurat doganore*

Tschäni and Wiedmer (2001) tërheqin vëmendjen për: (i) aplikime arbitrare të çmimeve të referencës (sipas ankesave të përfaqësuesve të biznesit), por edhe për orvajtje të shpeshta të importuesve për të përdorur fatura false (sipas opinioneve të zyrtarëve të

<sup>49</sup> Rekomandimet e studimit të Fias-it lidhur me pengesat administrative ndaj investimeve lidhur me licensimin, konsistojnë në (i) eliminimin e licensave për ‘industrinë jo ushqimore’, (ii) rishikimin e licensave në sektorët e tjerë, të justifikuar me interesa jetësore publike, duke synuar kufizimin e tyre; dhe (iii) rekomandimin që për kufizimin e licensave në sektorët e tjerë të zbatohet një ‘liste negative’ (Fias, 2003).

<sup>50</sup> Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 398, datë 13.6.2003 “Për heqjen e Licensave në Industrinë Joushqimore”, detyrimi i licensimit të personave fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari në (i) metalurgji mekanike; (b) lëkurë-këpucë; (c) tekstil-konfeksione; (d) gomë plastike; (e) qelq-qeramikë; (f) dru-letër; (g) kimikate, etj., zëvendësohet me detyrimin për të deklaruar aktivitetin pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës, duke paraqitur edhe dokumentacioni përkatës (megjithëse Vendimi nuk shprehet drejtpërdrejt për heqjen e licensave në këta sektorë).

doganave); (ii) nevojën për rritjen e informacionit dhe forcimin e dialogut midis sektorit privat dhe administratës doganore; (iii) nevojën për lidhjen e marrëveshjeve me administratat doganore të vendeve fqinjë dhe për harmonizimin e procedurave dhe dokumentacionit doganor; (iv) nevojën për përmirësimin e funksionimit të administratës doganore, për rritjen e transparencës dhe për forcimin e luftës ndaj korrupsionit.

Raporti i Fias (2003), mbi bazën e analizës së gjendjes së sistemit doganor, tërheq vëmendjen, ndër të tjera, për (i) rishikimin e procedurave të importit, të eksportit dhe të tranzitit, dhe zbatimin e metodës së ‘menaxhimit të riskut’, duke thjeshtuar kërkesat për dokumente, duke shpejtuar përpunimin doganor, dhe duke reduktuar kostot për sektorin privat; (ii) përcaktimin e kriterëve dhe rregullave të qarta për vlerësimin doganor mbi bazën e kërkesave të Nenit VII të GATT, duke synuar në minimizimin e vendimeve subjektive dhe arbitrare; vlerësimin e mundësive për përdorimin e asistencës së inspektimit ndërkombëtar lidhur me vlerësimin doganor; dhe (iii) forcimin e procedurave të operimit të brendshëm, përmirësimin e marrëdhënieve me biznesin privat, dhe përmirësimin e sistemit të apelimit.

Shqetësime dhe rekomandime të ngjashme shprehen edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë (2004), ku tërhiqet vëmendja për “mangësi të vërejtura në procedurat dhe rregullat e tranzitimit, të vlerësimit doganor, të rregjimit të magazinave doganore, të vlerësimit të riskut dhe të auditimit”.

Megjithë procesin reformues të cilit i është nënshtruar sistemi doganor i asistuar nga CAM-Albania dhe arritjet e rëndësishme veçanërisht kohët e fundit edhe në reflektim të vërejtjeve e sugjerimeve të shënuara më sipër, mendojmë se:

(i) Ende vazhdon të zotërojë përdorimi i *çmimeve të referencës*, ndërkohë që sipas Marrëveshjes së OBT për Klasifikimin dhe Vlerësimin Doganor, çmimet e referencës do të mund të përdoren vetëm po të ishin ezauruar katër metodat e tjera alternative. Sipas studimit të ACIT mbi ‘Lehtësimin e Procedurave Doganore’ (2004), bizneset vlerësojnë se çmimet e referencës përdoren në më shumë se 60% të rasteve<sup>51</sup>, ndërkohë që çmimet e transaksionit (sipas faturave përkatëse) përdoren vetëm në më pak se 35% të rasteve<sup>52</sup>. Vetëm në një përqindje të pakonsiderueshme, sipas të intervistuarve, për vlerësimin doganor janë përdorur metoda e çmimeve të mallrave të ngjashme dhe metoda e vlerës së llogaritur (përkatësisht 4,9% dhe 2,8%). Kjo do të thotë se në një masë të madhe çmimet e referencës vazhdojnë të luajnë rolin e tyre si si *çmime dysheme*. Përfaqësuesit e bizneset ankohen gjithashtu se në mjaft raste çmimet e referencës ngurtësohen për periudha relativisht të gjata dhe nuk pasqyrojnë dinamikën e çmimeve ndërkombëtare. Së fundi, sipas përfaqësuesve të biznesit, në mjaft raste çmimet e referencës zbatohen në mënyrë arbitrare dhe selektive dhe hapësirat për qëndrime subjektive dhe abuzive nga ana e nëpunësve të doganave janë të mëdha. Sipas të dhënave nga administrata doganore, gjatë viteve 2002-2003 janë bërë 700 apeline për rivlerësim, nga të cilat 602, ose 86%, janë pranuar. Ky është tregues pozitiv lidhur me efektshmërinë e apelimit, por nga ana tjetër nxjerr në pah shkallën e lartë të pasaktësive apo arbitraritetit në vlerësimin doganor. Për gjysmën e parë të vitit 2004, shifrat kanë qenë përkatësisht 50 dhe 37, ose 74%.

Argumenti i përdorur nga administrata doganore për përdorimin e çmimeve të referencës si një mjet për t’iu kundërvënë prirjeve për evazion fiskal duket i bazuar, por

<sup>51</sup> Është konsideruar vetëm përqindja e të intervistuarve që janë përgjigjur se çmimet e referencës përdoren ‘shumë shpesh’.

<sup>52</sup> Përseri është konsideruar vetëm përqindja e të intervistuarve që janë përgjigjur se çmimet e transaksionit përdoren ‘shumë shpesh’.

vlera e tij është e kufizuar. Kontrolli pas zhdoganimit<sup>53</sup>, auditimi efektiv dhe veprimet e kombinuara dhe të koordinuara me administratën tatimore, do të ishin metoda më efektive për adresimin e problemit të evazionit fiskal.<sup>54</sup>

(ii) Janë bërë hapa pozitivë në drejtim të thjeshtimit të *procedurave doganore* dhe shkurtimit të kohës së zhdoganimit. Sipas studimit të ACIT (2004), koha e zhdoganimit është ulur ndjeshëm krahasuar me periudhën të cilës i referohet Fias (2003): nga 5,3 ditë, në 1,9 ditë (14,8 orë)<sup>55</sup>. Megjithatë, koha e zhdoganimit që rezulton nga pyetësi, megjithëse të krahasueshme me disa vende të rajonit, mbetet mjaft e lartë krahasuar me vendet e zhvilluara<sup>56</sup>. Pritet që zbatimi i plotë i sistemit ASYCUDA dhe përmirësimi i menaxhimit duke u mbështetur më shumë tek menaxhimi i riskut dhe kontrolli pas zhdoganimit, si dhe thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave të zhdoganimit, të sjellin shkurtim të mëtejshëm të kohës së zhdoganimit. Lidhur me procedurat doganore, në drejtim të thjeshtimit të tyre do të kontribuonte edhe delegimi i një sërë kompetencash që sot i ka Drejtoria e Përgjithshme, tek drejtoritë rajonale apo degët doganore. Drejtoria e Përgjithshme do të mund ta luante më mirë rolin e saj në këtë rast nëpërmjet nxjerrjes së udhëzimeve të qarta dhe kontrollit të zbatimit të tyre.

(iii) Mbështetur në studimin e ACIT (2004), një drejtim tjetër ku kërkohet përmirësim rrënjësor i punës së doganës, është *etika* e punonjësve të administratës doganore. Rreth 59% e të intervistuarve pohojnë se ‘etika paraqitet e dobët dhe me mangësi’, ndërsa ‘mbi 40% e të intervistuarve përgjigjen se sjellja e punonjësve të doganave është bërë më negative’. Nga studimi rezulton se shqetësuese për bizneset janë çfaqjet jo të rralla të sjelljeve abuzive dhe korruptive të doganiereve.

(iv) Me gjithë përparimet që janë bërë, vërehen probleme lidhur me *transparencën* e veprimtarisë së administratës doganore dhe *informimin* e biznesit. Në jo pak raste, udhëzimet apo rregulloret në zbatim të ligjeve apo vendimeve përkatëse ose mungojnë, ose nuk janë në dispozicion të bizneseve. Hapat pozitivë të ndërmarrë për pasurimin e faqes së internetit të administratës doganore, duhen avancuar më tej. Më shumë mbetet për të bërë për informimin më të plotë të bizneseve lidhur me të drejtat e subjekteve për të marrë informacion dhe detyrimet përkatëse të administratës doganore.

(v) Në veprimtarinë e administratës doganore duket se në disa raste vazhdojnë të kenë ‘mbipeshë’ objektivat afatshkurtra të sigurimit të të ardhurave për buxhetin. Kjo pasqyrohet edhe në tentativa për të vendosur ‘pagesa mbitarifore’ në rastin e importit të mallrave të rëndësishme, si nafta, etj.

(vi) Reduktimi i pengesave jotarifore që lidhen me veprimtarinë doganore kërkon gjithashtu përmirësim të mëtejshëm të procedurave të rregjimeve të përkohshme, si

---

<sup>53</sup> Kohët e fundit pranë drejtorisë përgjithshme të Doganave është krijuar Njësia e Kontrollit pas Zhdoganimit. Gjithashtu janë marrë edhe masa të tjera lidhur me vlerësimin doganor, si perpjekjet për unifikimin e metodave të vlerësimit për të gjitha degët doganore, emërimi në degët doganore i punonjësve që merren me vlerësimin doganor, etj.

<sup>54</sup> Për më shumë, shih IMF (2002): *Albania, Progress with tax and Customs Administration Reforms*.

<sup>55</sup> Sipas informacioneve nga burime administrative, koha mesatare e zhdoganimit të importeve pas prezantimit të të gjithë dokumenteve të kërkuara, është 4 orë, dhe koha minimale, 2 orë. Në rastin e zbatimit të procedurave të përshpejtuara, vetëm 1 orë. Sipas ligjit përkatës, koha e zhdoganimit për importet është 3 orë deri në 1 ditë në rastin e transportit tokësor, dhe 2 deri 5 ditë në rastin e transportit detar. Sidoqoftë, këtu duhet të mbahet parasysh se shumë vonesa lidhen pikërisht me kohën para dorëzimit të dokumenteve.

<sup>56</sup> Për këto vende koha e zhdoganimit arrin mesatarisht në 5,6 orë në rastin e mallrave që transportohen në rrugë detare, dhe vetëm 0,7 orë për mallrat që transportohen në rrugë ajrore (ACIT, 2004).

rregjimit të magazinimit doganor, rregjimit të tranzitimit, etj., si dhe procedurave të apelimit, për të cilat në studimin e ACIT (2004) janë dhënë një sërë rekomandimesh.

Sistemi dhe procedurat doganore, sikurse nënvizohet në Marrëveshjen e Rishikuar të Kiotos 2000, ‘nuk duhet të shërbejnë apo të identifikohen si pengesa ndaj tregtisë ndërkombëtare dhe rritjes’. Kjo do të kërkonte zbatimin e rekomandimeve të Marrëveshjes, sipas të cilave një administratë moderne doganore duhet (i) Të zbatojë procedura standarde dhe të thjeshta; (ii) të zhvillojë dhe përmirësojë vazhdimisht teknikat e kontrollit doganor; (iii) të përdorë në maksimum teknologjinë e informacionit; (iv) të zhvillojë bashkëpunimin midis doganave dhe bizneseve private<sup>57</sup>.

Hemstead (2004, f. 26), raporton si pengesë për importet shqiptare (ankesa vjen nga pala serbe e malazeze) *procedurat doganore*, që vlerësohen si ‘të ngadalta, joeficiente dhe të korruptuara’. Lidhur me procedurat doganore në Shqipëri në këtë raport nënvizohen ‘procedura klasifikimi doganor jotransparente dhe jokonsistente’, dhe ‘nxitje financiare që u ofrohen zyrtarëve të doganave në varësi nga niveli i të ardhurave të mbledhura, të tilla që ndikojnë negativisht në procedurat ezhdoganimit”.

### *Subvencionet*

Ndihma shtetërore aktualisht realizohet në forma të ndryshme. Synimi ynë në këtë punim nuk është të analizojmë në mënyrë të plotë ndimën shtetërore (subvencionet) në Shqipëri, por thjesht të shohim disa nga problemet që mund të ketë në këtë fushë.

Disa nga format e ndihmës shtetërore lidhen drejtpërdrejt me funksionin e shtetit si pronar. Një formë e ndihmës shtetërore që lidhet me këtë funksion të shtetit, është *subvencionimi i ndërmarrjeve shtetërore* (publike), veçanërisht atyre që punojnë në fusha të ndryshme të shërbimit publik, që prej kohësh vazhdojnë të punojnë me humbje.

Një formë tjetër e ndihmës shtetërore që buron nga funksioni i shtetit si pronar, lidhet me *dhënien me qera të objekteve të pronës shtetërore*. Dhënia me qera e objekteve shtetërore rregullohet nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 24.04.2003 “Për dhënien me qera të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”. Ky vendim, sikurse përcaktohet edhe në botimin e Ministrisë së Ekonomisë “Ndhimja shtetërore-përmbledhje e legjislacionit evropian” (2003) përmban disa elementë të ndihmës shtetërore: (i) tarifa e qeradhënies është më e ulët se ajo e tregut; (ii) tarifa e qeradhënies ndryshon sipas gjendjes ekonomike të zonës apo rajonit ku ndodhet prona shtetërore; (iii) tarifa e qeradhënies ulet me rritjen e vendeve të punës, apo investimet e kryera nga ndërmarrja qeramarrëse. Për shembull, mjafton që ndërmarrja qeramarrëse të krijojë 5 vende pune, që ajo të përfitojë një zbritje të qerasë me 5%. Në qoftë se ndërmarrja krijon mbi 500 vende pune, qeraja vjetore ulet me 50%. Lidhur me investimet, mjafton që vlera e tyre të arrijë në 200 mijë dollarë amerikanë, që qiraja vjetore të ulet me 5%. Në qoftë se vlera e investimit është mbi 1000 dollarë amerikanë, qeraja vjetore ulet me 30%. Për më tepër, vihet re se kushtëzimet lidhur me punëzënien apo vlerën e investimit nuk varen aspak nga madhësia e objektit që jepet me qera, gjë që i bën këto kushtëzime joefektive.

Në Shqipëri funksionojnë *skema të mbështetjes sektoriale*, si në bujqësi, turizëm, energji elektrike, etj., *skema të mbështetjes së zhvillimit rajonal*, skema për *nxitjen e punësimit dhe të përkrahjes sociale*, etj.

Një ndër kërkesat që burojnë nga Projekt-Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ende në proces negocimi, është detyrimi për të bërë një inventar të plotë të skemave të ndihmës

<sup>57</sup> The Revised Kyoto Convention 2000, f. 2, WCO.

shtetërore që veprojnë në Shqipëri dhe kategorizimin e këtyre skemave sipas kritereve të Komunitetit Evropian. Neni 71 i Projekt-Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit përcakton kushtet e ndalimit të një ndihme shtetërore<sup>58</sup>, si dhe detyrimin e palës shqiptare për të bërë ndryshimet e duhura ligjore dhe institucionale në funksion të zbatimit të Marrëveshjes. Ndër ndryshimet e parashikuara, është ngritja e një autoriteti të pavarur dhe me kompetenca të plota për të autorizuar skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale në formë granti, si dhe kompetencat për të urdhëruar rikthimin e ndihmave shtetërore që janë dhënë në mënyrë të paligjshme.

Në fushën ligjore dhe rregullatore kërkohet hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor<sup>59</sup>, që do të mishërojë konceptet dhe parimet bazë të legjislacionit evropian në këtë fushë, do të rregullojë marrëdhëniet institucionale në të gjitha fazat e programimit dhe dhënies së ndihmave shtetërore, dhe do të përcaktojë strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e skemave të ndihmës.

Lidhur me subvencionet, duhet gjithashtu të mbahet parasysh detyrimi për vendet anëtare në OBT, pra edhe i Shqipërisë, për të dërguar programin e tyre të subvencioneve në sekretariatit e OBT-së çdo vit, duke dhënë informacion mbi tipin e subvencionit, masën e tij, objektivat politike, kohëzgjatjen e parashikuar, si dhe statistikën që bëjnë të mundur përcaktimin e efektit të tij në tregti.

Inflacioni i premtimeve subvencionuese në pragfushatën elektorale të këtij viti (2005) tregon sesa pak njihen dhe mbahen parasysh nga përfaqësuesit e spektrit politik shqiptar kërkesat që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në OBT dhe nga procesi integruar i saj në BE lidhur me politikën subvencionuese.

#### *Dimensioni 'administrativ' i masave jotarifore dhe kufizimi i tregtisë*

Sikurse u nënvizua edhe në pjesën e parë të punimit, sado e nevojshme të paraqitet një masë jotarifore dhe sado të mëdha të jenë efektet pozitive të pritura prej saj, aspektet administrative të zbatimit mund ta shndërrojnë atë në një pengesë jotarifore për tregtinë. Kjo ndosh kur zbatimi masës është shumë i kushtueshëm për biznesin në termat monetarë (kur pagesat për shërbimet nuk pasqyrojnë kostot e shërbimit) apo në termat e kohës së harxhuar, dhe shumë bezdisës për të. Dobësitë institucionale dhe sjelljet jo rrallë abuzive e korruptive të nëpunësve të administratës që lidhet me zbatimin e masave përkatëse, janë faktorë që e rrisin peshën e natyrës 'administrative' të pengesave jotarifore në rastin e Shqipërisë.

Përgjithësisht, dobësitë në funksionimin e institucioneve publike, sorrollatjet burokratike, mungesa e transparencës, subjektivizmi dhe arbitrarizmi në vendimmarrje, shfaqjet e korrupsionit, etj., reflektohen si pengesa serioze ndaj investimeve dhe si faktorë përkeqësues të klimës së biznesit. Duke keqësuar klimën e biznesit, ato paraqiten edhe si faktorë pengues ndaj tregtisë.

Raporti i Bankës Botërore "Shqipëria, Ruajtja e Rritjes së Qëndrueshme edhe Përtej Tranzicionit" (WB, 2004), identifikon përmirësimin e qeverisjes si një faktor vendimtar për investimet dhe rritjen ekonomike. Raporti nënvizon se qeverisja e dobët

---

<sup>58</sup> Sipas paragrafit I, pika (iii) të Nenit 71 të Projekt-Marrëveshjes së Asocim-Stabilizimit (që pasqyron përmbajtjen e Nenit 87 të Traktatit të BE), çdo ndihmë shtetërore, e cila deformat ose kërcënon të deformat konkurrencën me anë të favorizimit të ndërmarrjeve apo produkteve të caktuara, bie në kundërshtim me Projekt-Marrëveshjen, për sa kohë që ajo ndikon në tregtinë midis Komunitetit dhe Shqipërisë.

<sup>59</sup> Aktualisht është hartuar një projektligj për ndihmat shtetërore.

transmetohet shpesh në institucione publike jofunksionuese, të cilat ndikojnë negativisht në klimën e biznesit.

Studimi i kohëve të fundit mbi barrierat jotarifore në Evropën Jugë lindore i Cottier, Bürgi, Wüger, and Foltea (2005), identifikon si fusha prioritare në këto vende lidhur me përpjekjet për reduktimin e pengesave jotarifore, (i) procedurat doganore; (ii) rregullat teknike dhe standardet; (iii) politikat për lëshimin e vizave<sup>60</sup>; (iv) dhe rregullim i transportit. Problemet që lidhen me *burimet dhe infrastrukturën*<sup>61</sup> (përfshirë infrastrukturën doganore, infrastrukturën e sistemit të standardeve dhe testimi, si dhe infrastrukturën rrugore) konsiderohen të një prioriteti të lartë, por zgjidhja e të cilave do të kërkonte afate më të gjata kohore.

#### *Pengesat jotarifore dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Dokumentit të Partneritetit Evropian.*

Një kapitull i veçantë në Planin e Veprimit në kuadrin e partneritetit evropian (Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, 2004), i kushtohet ‘tregut të brendshëm’ dhe tregtisë dhe posaçërisht lëvizjes së mallrave; doganave; tatimeve; konkurrencës dhe ndihmës shtetërore; prokurimit publik dhe pronësisë intelektuale.

Lidhur me lëvizjen e mallrave, krahas masave dhe veprimeve të parashikuara në fushën e rregullave teknike, standardeve, testimi e certifikimit, një rëndësi të veçantë kanë masat e parashikuara për ngritjen e sistemit të mbikëqyrjes së tregut, në përputhje me standardet evropiane. Ngritja e sistemit të mbikëqyrjes së tregut konsiderohet në dokument si domosdoshmëri ‘në kushtet e mungesës së koordinimit, përcaktimit të detyrimeve ligjore dhe përgjegjësiwe institucionale midis strukturave ekzistuese publike të kontrollit të tregut...Ky sistem do të sigurojë respektimin e kërkesave të sigurisë së mallrave dhe shërbimeve të ofruara për konsumatorët edhe pas hedhjes së tyre në treg brenda vendit ...’ (Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, 2004, f. 219).

Lidhur me lehtësimin e procedurave doganore, disa nga masat që parashikohet të realizohen gjatë viti 2005, janë (i) zbatimi i plotë i programit ASYCUDA++, dhe mbi këtë bazë zbatimi më gjerësisht dhe në mënyrë më efektive i metodës së menaxhimit të riskut dhe përmirësimi i procedurave të tranzitimit; (ii) përmirësimi i marrëdhënieve me sektorin privat duke krijuar një komitet konsultativ brenda sistemit doganor; (iii) ngritja e komisionit të Apelit; (iv) paraqitja për miratim e draftit të ri të Kodit Doganor.

Masat e parashikuara në Planin e Veprimit në fushat që lidhen me pengesat (masat) jotarifore, synojnë para së gjithash në përafrimin ligjor dhe institucional me BE. Duke iu referuar matricave që shoqërojnë Planin e veprimeve, mund të thuhet se në jo pak raste do

---

<sup>60</sup> Hemstead (2004) raporton Shqipërinë si një vend që paraqet vështirësi lidhur me lëshimin e vizave komerciale, sipas pretendimeve nga Serbia dhe Mali i Zi.

<sup>61</sup> Problemet që lidhen me burimet dhe infrastrukturën konsiderohen si probleme që ndeshen në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor në studimin e BE lidhur me pengesat jotarifore në këtë rajon (Hemstead, 2004). Ndër të tjera, lidhur me Shqipërinë në këtë studim nënvizohet ‘sistemi i papërshtatshëm dhe i degraduar i rrugëve’ dhe ‘mungesa e konkurrencës në transportin rrugor’ (f. 14). Lidhur me standardet dhe sistemin e akreditimit, nënvizohet ‘mungesë ose pamjaftueshmëri serioze të laboratorëve akreditues dhe të instituteve kompetente të testimi dhe certifikimit’ dhe ‘për rrjedhojë, paaftësi për të marrë pjesë në marrëveshje të njohjes reciproke dhe në marrëveshje ndërkombëtare mbi metrologjinë dhe vlerësimin e konformitetit’ (f. 12). Gjithashtu, lidhur me Shqipërinë në këtë studim tërhiqet vëmendja për probleme të infrastrukturës së përgjithshme ekonomike e financiare, si ‘papërshtatshmëria dhe jofleksibiliteti i sistemit bankar’ dhe ‘mungesa e skemave të përshtatshme të sigurimit të kredisë’ (f. 13).

të ishte më i dëshirueshëm një kalendar më i ngjeshur dhe veprime më intensive, me objektiva më konkrete dhe ritëm më i shpejtë.

## **PËRFUNDIME**

Procesi i liberalizimit dhe hapjes tregtare të Shqipërisë po nxjerr në krye të axhendës së diskutimeve pengesat jotarifore. Harmonizimi i rregullave dhe procedurave të trajtimit të pengesave jotarifore midis vendeve të rajonit në kuadrin e Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë, dhe përafrimi i këtyre rregullave dhe procedurave me ato të BE, përfaqësojnë një nga drejtimit kryesore të thellimit të proceseve integruese të Shqipërisë. Për Shqipërinë, sikurse edhe për vendet e tjera të rajonit, një pjesë e rëndësishme e pengesave, më saktë ‘masave’ jotarifore, fitojnë një dimension të veçantë, atë të ‘institucioneve të tregut’ dhe ‘institucioneve të integritit’. Roli që pritët të luajnë harmonizimi i standardeve, rregullave teknike, procedurave të vlerësimit të konformitetit, etj. në nxitjen e eksporteve shqiptare, i shndërron këto ‘masa jotarifore’ edhe në institucione të rritjes së aftsisë konkurruese të ekonomisë.

Për shkak të mungesës së bazës së nevojshme rregullatore dhe dobësive institucionale, masat jotarifore në rastin e Shqipërisë vuajnë nga ‘mbipesha’ administrative, që shpesh i kualifikon ato si pengesa jotarifore edhe kur lidhen me interesa të tilla të rëndësishme, si ruajtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve, bimëve; siguria kombëtare, etj.

Përshpejtimi i procesit të përafrimit të bazës ligjore e rregullatore, dhe e institucioneve që lidhen me masat jotarifore me ato të BE, përbën edhe çelësin e suksesit në përpjekjet për reduktimin dhe eliminimin e pengesave jotarifore. Një drejtim i rëndësishëm i këtyre përpjekjeve është lehtësimi i procedurave doganore, por po rritet mprehtësia e problemeve që lidhen me ndihmën shtetërore (subvencionet), loja me të cilat vazhdon të mbetet mjaft e preferuar në garat politike.

Është e nevojshme të ndërmerren studime të kualifikuara për identifikimin dhe matjen e efekteve të pengesave jotarifore, në mënyrë që të bëhen efektive edhe politikat për reduktimin e tyre.



## Referenca

- ACIT (2004): *Lehtësimi i Procedurave Doganore dhe i Marrëdhënieve të Biznesit me Administratën Doganore*. Studim i realizuar me financimet e ofruara nga USAID dhe Fondacionit Për Shoqërinë e Hapur, Tiranë.
- Anderson, James E. And Neary, Peter J. (1991): *A new Approach to Evaluating Trade Policy*, World Bank Working Paper, World Bank, Washington DC.
- Anderson, James E. And Neary, Peter J. (1994): *The trade Restrictivness of Multy-Fibre Arrangement*, World bank Economic Review, Vol. 8, N0.2, May, pp. 151-169.
- Baldwin, Robert (1970): *Non-tariff Distortions in International Trade*, Brookings Institution, Washington DC.
- Bernard M. Hoekman and Michel M. Kostecki “The Political Economy of the World Trade System – The WTO and Beyond”, second edition, Oxord University Press, 2001.
- Bhagwati, J. (1998): *Proteksionizmi*, Cambridge, Mass.: Mit Press.
- Bhala, Raj (2001): *International Trade Law: Theory and Practice*, second edition, LEXIS Publishing. f.499-578
- Bora, Bijit; Kuwahara, Aki and Laird, Sam (2002): *Quantification of Non-Tariff Measures*, Policy issues in International Trade an Commodities Sduty serie No. 18, UNCTAD, New York and Geneva.
- Cottier, Bürgi, Wüger, and Foltea (2005): *Helping to tackle non-tariff barriers in South Eastern Europe*, World trade Institute, Berne.
- Commission of the European Communities (2004) *Albania, Stabilization and Association Report 2004*, Commision Staff Working Paper, Brussels
- Deardorff, Alan and Stern, Robert (1986): *The Michigan Model of World Production andTtrade*, MIT Press, Cambridge, Mass.
- Deardorff, Alan and Stern, Robert (1998): *The Measurement of Non-Tariff Barriers*, OECD Economic Department Working Papers No. 179, OECD, Washington DC.
- FIAS 2003. *Albania: Removing Administrative Barriers To Investment: A Critical Component Of The National Development Strategy*. Washington, D.C.: Foreign Investment Advisory Service.
- Hemstead, Hemel (2004), *Helping to tackle non-tariff barriers in South Eastern Europe*, European Union Project in the Countries of the Weastern Balkans, United Kingdom

- Hoekman, B and Kostecki, M. (2001): *The Political Economy of the World Trading System – The WTO and Beyond*, second edition, Oxford.
- IMF (FAD) Report (Highfield, R. Crandall, W. and Harrison, G.), *Albania: Progress With Tax and Customs Administration Reforms*, November 2002.
- Laird, Sam and Vossenaar René (1991): *Porqué nos preocupan las barreras no arancelarias?* Information Comercial Espanola, Special Issue on Non tariff Barriers, November, pp.31-54.
- Mançellari, A (2004): Internal Market and Trade Integration-the case of Albania, Report prepared under the specific Grant Agreement RELEX I-2 190202 REG 4-14.
- Messerlin, Patrik. A. and Mirdout, Sébastien (2004): *Trade Liberalization in South East Europe: Review of conformity of 23 FTAs with MoU*, Groupe D'Economie mondiale, Sciences Po.
- Nelsen, P. Chantal, with Jensen, Hans and Brockmeier, Martina (2004): *Schenarios for Exmaniming General trade Agreement*, ENAPRI, working paper no. 8
- Pacific Economic Cooperation Council (PECC) (2001): *Impediments to Trade and Investment in the APEC Region*, PECC Secretariat, Singapore.
- Paktin e Stabilitetit për Evropën Jugë lindore (2003), *Strategy and Action Plan 2004*, Working Group on Trade Liberalization and Facilitation.
- Philipson, Agnete (2001) *Guide to the Concept and Practical Application of Articles 28-30 EC*, European Commission, Internal Market DG.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë (2003): *Ndihma Shtetërore, Përmbledhje e Legjislacionit Evropian*.
- Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave (2004) *Plani i Veprimit për zbatimin e prioritetëve të dokumentit të partneritetit evropian*.
- Richardson, M (1993): *Endogenous Protection and Trade Diversion*, Journal of International Economics, 34, pp. 309-324.
- Schott, Jeffrey (2004): *Reviwing the Doha Raund*, Institute for International Economics.
- Stability Pact For South Eastern Europe (2003), *Strategy and Action Plan 2004*, Working Group for trade Liberalization and Facilitation.
- Tschäni, H. and Wiedmer, L. (2001), *Non-tariff barriers to trade in the core countries of the stability pact for South Eastern Europe*.

- United Nations Economic and Social Commission for Asia and the Pacific (UNESCAP) (2000): *Non-tariff measures with Potentially Restrictive Market Access Implications Emerging in a Post-Uruguay Round Context*, Studies in trade and Investment NO. 40 (ST/ESCAP/2024), Bangkok, UNESCAP.
- UNCTAD (1994): *Directory of Import Regimes, Part I Monitoring Import Regimes* (UNCTAD/DMS/2(Part I)/Rev. 1, Sales No. E.94.II.D.6), United Nations, New York.
- Unter, B. (1998): *Maximizing Customs Benefits: A Global Model for Regulatory Reform*, Paper presented at the Us-China Standards, Testing and Certification Workshop, Washington DC, February 17-18.
- USITC (1989): *The Economic Effects of Significant U.S. Imports Restraints, Phase I: Manufacturing*, Report to the Committee on Finance of the united states senate on Investigation no. 332-262 under the Section 332 of the Tariff Act of 1930, USITC Publication 2222 (October).
- USITC (1990): *The Economic Effects of Significant U.S. Imports Restraints, Phase II: Agriculture products and Natural resources*, , Report to the Committee on Finance of the united states senate on Investigation no. 332-262 under the Section 332 of the Tariff Act of 1930, USITC Publication 2314.
- Venables, A. J. And Smith, A. (1998): *Completing the Internal Market in the European Community: Some Industry Simulations*, European Economic Review, No. 32 (September), pp. 1501-1525.
- Vhalley, John (1985): *Trade Liberalization among Major World Trading Areas*, MIT Press, Cambridge, Mass.
- Walkenhorst, Peter and Fliess, Barbara (2003): *Non-tariff measures affecting EU exporters: evidence from a complaints-inventory*, Economics Department Working Paper No.373, OECD.
- World Bank (2002): *Development, Trade and WTO, A Handbook*. Editors: Bernard Hoekman, Aaditya Mattoo, and Philip English.

## ANEKS

Tabela A1: Sistemi i koduar i UNCTAD për barrierat jotarifore

### UNCTAD coding system of trade control measures

Code	Description
<b>1000</b>	<b>TARIFF MEASURES</b>
1100	STATUTORY CUSTOMS DUTIES
1200	MFN DUTIES
1300	GATT CEILING DUTIES
1400	TARIFF QUOTA DUTIES
1410	Low duties
1420	High duties
1500	SEASONAL DUTIES
1510	Low duties
1520	High duties
1600	TEMPORARY REDUCED DUTIES
1700	TEMPORARY INCREASED DUTIES
1710	Retaliatory duties
1720	Urgency and safeguard duties
1900	PREFERENTIAL DUTIES UNDER TRADE AGREEMENTS
1910	Interregional agreements
1920	Regional and sub-regional agreements
1930	Bilateral agreements
<b>2000</b>	<b>PARA-TARIFF MEASURES</b>
2100	CUSTOMS SURCHARGES
2200	ADDITIONAL TAXES AND CHARGES
2210	Tax on foreign exchange transactions
2220	Stamp tax
2230	Import licence fee
2240	Consular invoice fee
2250	Statistical tax
2260	Tax on transport facilities
2270	Taxes and charges for sensitive product categories
2290	Additional charges n.e.s.
2300	INTERNAL TAXES AND CHARGES LEVIED ON IMPORTS
2310	General sales taxes
2320	Excise taxes
2370	Taxes and charges for sensitive product categories
2390	Internal taxes and charges levied on imports n.e.s.
2400	DECREEED CUSTOMS VALUATION
2900	PARA-TARIFF MEASURES N.E.S.
<b>3000</b>	<b>PRICE CONTROL MEASURES</b>
3100	ADMINISTRATIVE PRICING
3110	Minimum import prices
3190	Administrative pricing n.e.s.
3200	VOLUNTARY EXPORT PRICE RESTRAINT
3300	VARIABLE CHARGES
3310	Variable levies
3320	Variable components
3330	Compensatory elements

/...

<b>Code</b>	<b>Description</b>
3340	Flexible import fees
3390	Variable charges n.e.s
3400	ANTI-DUMPING MEASURES
3410	Anti-dumping investigations
3420	Anti-dumping duties
3430	Price undertakings
3500	COUNTERVAILING MEASURES
3510	Countervailing investigations
3520	Countervailing duties
3530	Price undertakings
3900	PRICE CONTROL MEASURES N.E.S.
<b>4000</b>	<b>FINANCE MEASURES</b>
4100	ADVANCE PAYMENT REQUIREMENTS
4110	Advance import deposit
4120	Cash margin requirement
4130	Advance payment of customs duties
4170	Refundable deposits for sensitive product categories
4190	Advance payment requirements n.e.s.
4200	MULTIPLE EXCHANGE RATES
4300	RESTRICTIVE OFFICIAL FOREIGN EXCHANGE ALLOCATION
4310	Prohibition of foreign exchange allocation
4320	Bank authorization
4390	Restrictive official foreign exchange allocation n.e.s.
4500	REGULATIONS CONCERNING TERMS OF PAYMENT FOR IMPORTS
4600	TRANSFER DELAYS, QUEUING
4900	FINANCE MEASURES N.E.S.
<b>5000</b>	<b>AUTOMATIC LICENSING MEASURES</b>
5100	AUTOMATIC LICENCE
5200	IMPORT MONITORING
5210	Retrospective surveillance
5220	Prior surveillance
5270	Prior surveillance for sensitive product categories
5700	SURRENDER REQUIREMENT
5900	AUTOMATIC LICENSING MEASURES N.E.S.
<b>6000</b>	<b>QUANTITY CONTROL MEASURES</b>
6100	NON-AUTOMATIC LICENSING
6110	Licence with no specific ex-ante criteria
6120	Licence for selected purchasers
6130	Licence for specified use
6131	Linked with export trade
6132	For purposes other than exports
6140	Licence linked with local production
6141	Purchase of local goods
6142	Local content requirement
6143	Barter or counter trade
6150	Licence linked with non-official foreign exchange
6151	External foreign exchange
6152	Importers own foreign exchange
6160	Licence combined with or replaced by special import authorization
6170	Prior authorization for sensitive product categories
6190	Non-automatic licensing n.e.s.
6200	QUOTAS
6210	Global quotas
6211	Unallocated

<b>Code</b>	<b>Description</b>
6212	Allocated to exporting countries
6220	Bilateral quotas
6230	Seasonal quotas
6240	Quotas linked with export performance
6250	Quotas linked with purchase of local goods
6270	Quotas for sensitive product categories
6290	Quotas n.e.s.
6300	<b>PROHIBITIONS</b>
6310	Total prohibition
6320	Suspension of issuance of licences
6330	Seasonal prohibition
6340	Temporary prohibition
6350	Import diversification
6360	Prohibition on the basis of origin (embargo)
6370	Prohibition for sensitive product categories
6390	Prohibitions n.e.s.
6600	<b>EXPORT RESTRAINT ARRANGEMENTS</b>
6610	Voluntary export restraint arrangements
6620	Orderly marketing arrangements
6630	Multi-fibre arrangement (MFA)
6631	Quota agreement
6632	Consultation agreement
6633	Administrative co-operation agreement
6640	Export restraint arrangements on textiles outside MFA
6641	Quota agreement
6642	Consultation agreement
6643	Administrative co-operation agreement
6690	Export restraint arrangements n.e.s.
6700	<b>ENTERPRISE-SPECIFIC RESTRICTIONS</b>
6710	Selective approval of importers
6720	Enterprise-specific quota
6790	Enterprise-specific restrictions n.e.s.
6900	<b>QUANTITY CONTROL MEASURES N.E.S.</b>
<b>7000</b>	<b>MONOPOLISTIC MEASURES</b>
7100	<b>SINGLE CHANNEL FOR IMPORTS</b>
7110	State trading administration
7120	Sole importing agency
7200	<b>COMPULSORY NATIONAL SERVICES</b>
7210	Compulsory national insurance
7220	Compulsory national transport
7900	<b>MONOPOLISTIC MEASURES N.E.S.</b>
<b>8000</b>	<b>TECHNICAL MEASURES</b>
8100	<b>TECHNICAL REGULATIONS</b>
8110	Product characteristics requirements
8120	Marking requirements
8130	Labelling requirements
8140	Packaging requirements
8150	Testing, inspection and quarantine requirements
8190	Technical regulations n.e.s.
8200	<b>PRE-SHIPMENT INSPECTION</b>
8300	<b>SPECIAL CUSTOMS FORMALITIES</b>
8900	<b>TECHNICAL MEASURES N.E.S.</b>

*Source:* UNCTAD (1994), which contains notes on certain measures as well as a set of working definitions for trade control measures.

Tabela A2: Shkalla e mbulimit nga NTB, sipas produkteve, për vende të veçanta

Description	China,						
	Australia	Brunei	Canada	Chile	China	Hong Kong	Thailand
Primary products (0-4, 68)	0.54	6.49	3.23	1.22	6.46	0.35	4.43
Agricultural products (0-2, 4)	0.63	7.61	3.52	1.43	7.30	0.41	3.35
Mining products (3, 68)	0.00	0.00	1.51	0.00	1.51	0.00	10.84
Manufactures (5-8 less 68)	0.31	2.43	20.89	0.17	8.00	0.49	1.07
Iron and steel (67)	0.24	0.00	83.33	0.00	44.85	0.44	1.87
Chemicals (5)	0.89	3.41	0.16	0.00	3.90	2.19	1.56
Other semi-manufactures (61-64, 66, 69)	0.49	6.72	1.47	0.00	1.36	0.00	1.22
Machinery and transport equipment (7)	0.07	2.90	0.11	0.73	14.02	0.00	1.92
Textile and clothing (65, 84)	0.06	0.00	81.26	0.00	2.85	0.00	0.00
Other consumer goods (81-83, 85, 87-89)	0.00	0.00	0.35	0.00	5.05	0.00	0.00
Other products (9)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
ALL PRODUCTS (0-9)	0.36	3.35	16.88	0.41	7.62	0.46	1.82
Description	Japan	Republic of Korea	Malaysia	Mexico	New Zealand	Papua New Guinea	Peru
Primary products (0-4, 68)	7.49	9.29	3.02	2.41	0.50	0.32	0.88
Agricultural products (0-2, 4)	7.69	10.76	3.53	2.54	0.59	0.37	1.03
Mining products (3, 68)	6.31	0.60	0.00	1.67	0.00	0.00	0.00
Manufactures (5-8 less 68)	5.08	0.37	2.41	0.80	0.37	0.01	0.03
Iron and steel (67)	0.48	0.00	7.97	0.00	0.00	0.00	0.00
Chemicals (5)	1.15	1.25	0.75	0.14	0.00	0.00	0.00
Other semi-manufactures (61-64, 66, 69)	0.64	0.16	0.90	0.08	0.73	0.08	0.00
Machinery and transport equipment (7)	0.05	0.00	4.29	2.25	0.21	0.00	0.07
Textile and clothing (65, 84)	23.06	0.38	0.30	0.00	0.00	0.00	0.06
Other consumer goods (81-83, 85, 87-89)	0.68	0.00	4.31	1.57	1.41	0.00	0.00
Other products (9)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
ALL PRODUCTS (0-9)	5.61	2.37	2.54	1.16	0.40	0.08	0.22
Description	Philippines	Russian Federation	Singapore	China, Taiwan Province of	Thailand	United States	Viet Nam
Primary products (0-4, 68)	0.74	1.13	0.61	21.17	6.32	4.69	0.43
Agricultural products (0-2, 4)	0.76	0.66	0.72	22.79	6.67	4.56	0.41
Mining products (3, 68)	0.61	3.92	0.00	11.60	4.22	5.44	0.54
Manufactures (5-8 less 68)	1.92	0.73	0.13	7.48	3.30	5.23	1.23
Iron and steel (67)	0.00	0.00	0.00	8.21	0.00	42.44	21.74
Chemicals (5)	4.67	0.65	0.00	15.30	0.24	3.35	0.12
Other semi-manufactures (61-64, 66, 69)	0.60	1.22	0.00	0.76	1.47	4.59	0.41
Machinery and transport equipment (7)	1.92	0.00	0.56	8.28	1.39	5.18	0.00
Textile and clothing (65, 84)	0.00	0.00	0.00	0.00	13.50	1.13	0.00
Other consumer goods (81-83, 85, 87-89)	2.65	2.84	0.00	11.93	0.00	0.92	0.00
Other products (9)	8.33	50.00	0.00	33.33	0.00	0.00	0.00
ALL PRODUCTS (0-9)	1.68	0.90	0.24	10.59	3.97	5.08	1.03
Description	Brazil	Egypt	European Union	India	South Africa		
Primary products (0-4, 68)	3.54	0.17	1.98	35.37	0.13		
Agricultural products (0-2, 4)	3.76	0.19	2.30	42.24	0.13		
Mining products (3, 68)	2.50	0.00	0.47	2.37	0.16		
Manufactures (5-8 less 68)	3.91	4.97	10.77	27.18	1.99		
Iron and steel (67)	0.49	0.00	51.94	0.00	2.91		
Chemicals (5)	0.87	0.00	4.18	16.73	1.67		
Other semi-manufactures (61-64, 66, 69)	2.20	0.31	0.86	28.18	1.77		
Machinery and transport equipment (7)	8.14	0.10	2.41	28.11	0.52		
Textile and clothing (65, 84)	5.36	65.68	87.21	80.58	10.30		
Other consumer goods (81-83, 85, 87-89)	6.85	0.00	4.82	61.17	2.29		
Other products (9)	0.00	0.00	0.00	50.00	0.00		
ALL PRODUCTS (0-9)	3.88	2.13	5.79	34.66	1.12		

Tabela A3: Ankesat e bizneseve për pengesat jotarifore sipas llojit të tyre dhe sektorëve

	All sectors	Goods in general	Agriculture	Mining	Food	Textiles & leather	Wood & paper	Chemicals	Mineral & metal products	Machinery
	100%	34%	10%	1%	14%	7%	2%	10%	2%	19%
<b>All non-tariff measures</b>										
<i>Core NTMs:</i>										
Price control measures	3%	○	⊙	●	●	○	○	●	●	○
Quantity control measures	14%	○	●	●	⊙	⊙	●	●	○	⊙
<i>Non-core border NTMs:</i>										
Para-tariff measures	9%	●	○	○	⊙	⊙	○	○	○	⊙
Financial measures	1%	●	○	○	○	○	○	○	●	○
Automatic licensing measures	1%	●	○	○	○	●	○	○	●	○
Monopolistic measures	3%	○	●	●	●	○	○	●	●	○
Customs procedures	6%	●	○	○	○	●	○	○	○	○
<i>Standards and certification:</i>										
Technical regulations	11%	○	⊙	○	●	⊙	●	⊙	⊙	⊙
Certification	15%	○	●	○	●	●	○	○	●	●
<i>Domestic governance:</i>										
Government assistance issues	6%	⊙	●	○	○	○	○	○	●	●
Public procurement issues	6%	●	○	○	○	○	○	○	○	○
Investment restrictions	8%	●	○	○	○	○	○	○	○	○
Distribution restrictions	2%	○	○	○	○	○	○	○	○	○
Transportation restrictions	1%	●	○	○	○	○	○	○	○	○
Lack of IPR protection	8%	●	○	○	○	○	○	○	○	○
Law enforcement issues	1%	●	○	○	○	○	○	○	○	○

Note: ●: the share of complaints about the particular measure in all complaints encountered in the particular sector is at least 25 per cent higher than for all sectors.  
 ○: the share of complaints about the particular measure in all complaints encountered in the particular sector is at least 25 per cent lower than for all sectors.  
 ⊙: the share of complaints about the particular measure in all complaints encountered in the particular sub-sector amounts to 75 to 125 per cent of the corresponding ratio for all sectors.

Source: Authors based on EU market access database.